



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

PARTNERITETI PËR QEVERISJEN E HAPUR

PLANI I KATËRT KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR QEVERISJEN E HAPUR PËR

SHQIPËRINË 2018 - 2020



PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| PARATHËNIE | 3 |
| METODOLOGJIA E PLANIT TË VEPRIMIT | 4 |
| Sistemi i Planifikimit të Integruar..... | 4 |
| Lidhja e proceseve dhe hartimi i Planit të Veprimit 2018-2020 | 4 |
| Kuari institucional për hartimin e Kuadrit Strategjik Kombëtar për Sistemin e Reformës Strukturore të Qeverisjes 2018-2022 | 5 |
| Fazat e procesit të hartimit të Planit të Veprimit 2018-2020 | 7 |
| SITUATA AKTUALE | 9 |
| KOMPONENTET | 15 |
| Qeverisje e hapur për ‘Better Regulation’ | 15 |
| Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe Qeverisjen E-Gov..... | 18 |
| Qeverisje e hapur për të rritur transparencën e raportimit qeveritar dhe përmirësuar aksesueshmërinë në informacion | 23 |
| Qeverisje e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta..... | 28 |

PARATHËNIE

Qeveria Shqiptare mbështet fuqimisht vlerat e promovuara nga Partneritetit për Qeverisje të Hapur dhe qëndron e përkushtuar në misionin e saj për ndërtimin e një qeverisje publike, në themel të së cilës qëndron transparenca, komunikimi dhe llogaridhënia.

Qasja jonë për jetësimin e parimeve dhe objektivave të qeverisjes së hapur bazohet në ndërtimin dhe shfrytëzimin e sinergjive krijuese midis aktorëve shtetërorë, partnerëve të huaj, shoqërisë civile dhe qytetarëve.

Qeveria Shqiptare vlerësoi nevojën për vendosjen e partneritetit për qeverisjen e hapur brenda një kuadri më të qëndrueshëm institucional, me qëllim rritjen e ekspozimit të iniciativës së PQH-së në Shqipëri dhe mundësinë për sigurimin e më tepër kapaciteteve njerëzore, burimeve teknike dhe financiare për zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në këtë kuadër.

Për këtë arsye plani kombëtar i veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2018-20 u hartua dhe do të mbikëqyret përmes mekanizimit të menaxhimit të integruar të politikave, si forumi kryesor në vend për dialogun politik midis përfaqësuesve të qeverisë, partnerëve për zhvillim e integrim dhe shoqërisë civile.

Ky plan veprimi parashikon angazhime të rëndësishme në mbështetje të proceseve kyçe të zhvillimit strategjik dhe integritit evropian vendit, si mirë-rregullimi dhe rritja e transparencës në qeverisje, mirë-menaxhimi i burimeve publike, përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe luftën ndaj korrupsionit.

Ne mbetemi të bindur që zbatimi i Planit të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2018-20 do ti shërbejë transformimit të qeverisjes në vend, në përputhje me parimet e kësaj iniciative mbarëbotërore dhe vetë kërkesave të shoqërisë dhe qytetarëve shqiptare.

Zëvendëskryeministre

Senida Mesi

METODOLOGJIA E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT

Sistemi i Planifikimit të Integruar

Planifikimi strategjik në Shqipëri bazohet mbi Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), i cili është miratuar fillimisht me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr.244, datë 21.4.2005 dhe më pas me VKM, Nr.692, datë 10.11.2005¹. SPI-ja ka si synim të sigurojë një kuadër të gjerë planifikimi brenda të cilit të gjitha politikat dhe planifikimi financiar i qeverisë të funksionojnë në mënyrë koherente, eficiente dhe të integruar. SPI konsiston në një kuadër parimesh dhe strukturash operuese që mundësojnë lidhjen më të harmonizuar të mundshme të gjithë proceseve planifikuese mes tyre.

Dy janë proceset themelore ku mbështetet SPI-ja:

- Një proces afatmesëm deri në afatgjatë të planifikimit strategjik, **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)**, e cila vendos prioritetet dhe qëllimet strategjike;
- Një proces i buxhetimit afatmesëm, **Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA)**, i cili kërkon që çdo ministri të hartojë një plan trevjeçar brenda tavanëve të shpenzimeve buxhetore për të arritur objektivat e politikave, në përputhje me SKZHI;

Lidhja e proceseve dhe hartimi i Planit të Veprimit 2018-2020

Metodologjia për procesin e hartimit të Planit të Veprimit 2018-2020 për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur bazohet në parimin e funksionimit të plotë të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale të lidhura me Sistemin e Planifikimit të Integruar.

Hartimi i Planit të Veprimit 2018-2020 për PQH-në mbështetet veçanërisht në harmonizimin sa më të mirë me ciklin e Programimit Buxhetor Afatmesëm dhe me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) si dhe me programimin strategjik të vendit (strategjitë sektoriale & ndërsektoriale).

Në veçanti, **Planit të Veprimit 2018-2020 për PQH-në** do të harmonizojë:

- **Lidhjen me prioritetet e Qeverisë Shqiptare dhe SKZHI II**, ku prioritetet e parashikuara në programin e Qeverisë, si edhe sektorët prioritarë të Qeverisë, janë pjesë integrale e vizionit dhe politikave që përcakton SKZHI.
- **Lidhjen e plotë midis PBA me PKIE**, ku aktivitetet, masat dhe angazhimet në kuadër të MSA janë pjesë integrale e PBA-së dhe e SKZHI.

¹ Miratuar fillimisht me VKM nr.244, datë 21.4.2005, “Për miratimin e strategjisë “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar”, i cili u shfuqizua me VKM nr. 692, datë 10.11.2005, “Për miratimin e strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i një sistemi planifikimit të integruar në Shqipëri”

- Lidhjen me politikat e përfshira në strategjitë kombëtare sektoriale dhe ndërsektoriale të vendit.

Kuadri institucional për hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020

Niveli vendimmarrës

Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administrimit Publik miraton Planin e Veprimit 2018-2020 për PQH-në.

Zëvendëskryeministri është Koordinatori Kombëtar në nivel politik për PQH-në dhe udhëheq GMIP-në për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik.

GMIP e MQ&AP përqëndrohet në prioritetin e Qeverisë Shqiptare për 'Mirëqeverisjen' në nivel qendror dhe lokal, e cila përbën themelin e SKZHI-së, duke synuar përmirësimin ofrimit të Shërbimeve Publike, përmirësimin e qeverisjes së hapur, përmirësimin e qeverisjes së sektorit publik dhe atij privat, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Qeverisja e fortë dhe efektive mbështet konkurrencën dhe rritjen, sepse ajo siguron një kornizë rregulluese të mirëfilltë për biznesin, grupet shoqërore dhe qytetarët dhe është thelbësore për anëtarësimin në BE. Qeverisja e mirë nxit llogaridhënien dhe transparencën e sektorit publik, si dhe decentralizimin efektiv dhe demokracinë në nivel lokal.

GMIP e MQ&AP koordinon politikat dhe monitorimin e zbatimit në këtë sektor më të gjerë përmes hartimit dhe zbatimit të një Kalendarit Pune që mbulon masat në lidhje me avancimin e shoqërisë civile, decentralizimin dhe qeverisjen lokale, reformën e administratës publike, ofrimin e shërbimeve publike, transparencën & anti-korrupsion, statistika, e-qeverisje dhe dixhitalizim dhe masa mbështetëse për Parlamentin.

Sekretariati Teknik për GMIP & OGP

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes është sekretariati teknik i GMIP-së si dhe koordinon procesin e hartimit dhe mbarëvajtjes së Planit të Veprimit 2018-2020 të PQH-së. **Njësia e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes/ Drejtoria e Mirëqeverisjes dhe Sistemeve, pjesë e Departamentit, në rolin e Sekretariatit Teknik** është përgjegjëse për koordinimin e të gjithë proceseve dhe punës së institucioneve për hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020. Sekretariati ndjek ecurinë e procesit në ministritë e linjës dhe raporton pranë Zëvendëskryeministrit për çështje të ndryshme të lidhura me PQH-në.

Grupet tematike koordinuese

Grupi i Punës në nivelin teknik: Për bashkërendimin në nivel qendror të institucioneve kyçe dhe menaxhim të të gjithë procesit, funksionojnë në kuadër të GMIP-së për Mirëqeverisje Grupet Tematike. Grupet Tematike (GT) janë grupe pune ndërministrorë të themeluara nën një GMIP për të koordinuar dhe monitoruar reformat dhe veprimet e ndërlidhura në një nënsektor të veçantë brenda sektorit "me shtrirje të gjerë" të mbuluar nga GMIP.

Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik mbulon GT me aktivitetin e fushave të mëposhtme

- **Sekretariati në nivelin teknik** GMIP & OGP kryesohet nga drejtori i Njesisë së Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në rolin e Sekretariatit Teknik dhe koordinon punën për:
 - përgatitjen e kapitullit të Kontekstit Strategjik
 - përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve Strategjike/komponentët e Planit të Veprimit
 - përgatitjen e kapitullit të Kuadrit të procesit të monitorimit
- **Grupet Tematike në nivelin teknik** udhëhiqen nga Lead Focal Point për çdo komponent dhe koordinojnë punën për:
 - përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
 - përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
 - përgatitjen e kapitullit të buxhetimit

Ministria e Financave dhe Ekonomisë garanton konsolidimin e kapitullit të buxhetimit. Në proces përfshihen ngushtësisht, si pjesë e grupit teknik të punës, drejtoria e përgjithshme e buxhetit, drejtoria e politikave makroekonomike e fiskale, etj.

Ministria e Drejtësisë garanton analizën e implikimeve legislative të Reformës si dhe propozimet e nevojshme në kuadrin rregullator në mbështetje të Planit të Veprimit.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme garanton lidhjen e Planit Kombëtar për Integrimin European (PKIE). Në proces përfshihen ngushtësisht, si pjesë e grupit teknik të punës, drejtoritë që kanë në funksionin e tyre: çështje të programimit IPA, si edhe drejtoritë për çështjet sektoriale dhe integrimin në BE.

Strukturat koordinuese në ministritë e linjës:

- **Koordinatori për Planin e Veprimit;** përbëhet nga një person kontakti për cdo ministri linje, që koordinon metodologjinë, kalendarin, proceset, raportimit dhe cdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Sekretarati Teknik.
- **Koordinatori koordinon punën me Sekretariatit GMIP dhe sekretariatet e Grupeve Tematike pr finalizimin e Planit të Veprimit.**
- Kjo strukturë e posacme garanton kontrollin e cilësisë për cdo dokument të draftuar dhe diskutuar nga drejtoritë e politikave, programeve, projekteve si edhe eficiencën dhe efektivitetin për procesin e hartimit të Planit të Veprimit, dhe është përgjegjëse për:
- Ndjekjen dhe zbatimin e planit të punës për draftimin e Kuadrit Strategjik për Sistemin,
- Raportimin pranë Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, në lidhje me ecurinë e procesit, si dhe relatojnë në grupet respektive për problematikat për zgjidhje,

- Garantoni koordinimin brenda ministrisë për të zbatuar Planin e Punës, në përputhje me kalendarin për hartimin e Kuadrit Strategjik,
- Garantoni cilësinë dhe dërgimin në kohë të drafteve,
- Siguron mbështetje teknike Sekretarit të Përgjithshëm për kryerjen e aktiviteteve koordinuese në funksion të draftimit të kapitujve respektivë.

Fazat e procesit të hartimit të Planit të Veprimit 2018-2020.

Mobilizimi i procesit me Ministrinë e Linjës (Qershor – Korrik 2018)

Fillimisht, fokusi u vendos në lançimin e procesit të hartimit të PVQH 2018-20 me ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore, si dhe përgatitjen e strukturave përkatëse që u angazhuan në proces. Aktivitete kryesore që u zhvilluan gjatë kësaj faze, nga Sekretariati Teknik, përfshinë:

- Lançimi e procesit në workshop të dedikuar (qershor 2018)
- Zhvillimin e takimeve të veçanta me çdo ministri linje.
- Organizimin e takimeve të Grupeve Tematike:
 - Grupi Tematik i Politikbërjes (qershor - shtator 2018)
 - Grupi Tematik i E-Gov (qershor - shtator 2018)
 - Grupi Tematik i Antikorrupsionit (qershor - shtator 2018)
 - Komiteti i Menaxhimit të Financave Publike (qershor - shtator 2018)

Finalizimi i konsultimit dhe miratimi në Grupet Tematike për komponentët respektive.

Përgjegjësitë kryesore institucionale në këtë fazë ishin:

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri

- Përgatitja e komenteve për draftet e para për politikat dhe masat prioritare nga ministrinë e linjës (shtator - tetor 2018)
- Rishikimi dhe përgatitja e draftit për konsultim të Planit të Veprimit (tetor 2018)
- Konsultimi me: grupet e interesit dhe partnerët socialë, donatorët dhe Shoqërinë Civile (tetor 2018)
- Hartimi i treguesve (qershor – shtator 2018)
- Finalizimi i draftit dhe paraqitja për diskutim/aprovim në GMIP (tetor - nëntor 2018)

Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Kryerja e analizave të kërkesave buxhetore dhe organizimi i seancave dëgjimore me ML, në bashkëpunim me Departamentin dhe MEPJ (shtator – tetor 2018)
- Konsolidimi i kapitullit të buxhetit (shtator 2018)
- Përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
- Përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)

Ministria e Drejtësisë/ Grupi Tematik për Antikorrupsionin:

- Përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
- Përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
- Përgatitjen e kapitullit të buxhetimit

Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit/ Grupi Tematik për E-Gov:

- Përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
- Përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
- Përgatitjen e kapitullit të buxhetimit

Ministria e Integrimit Europian:

- Paraqitja e komenteve për politikën dhe masat prioritare (qershor - shtator 2018).
- Dhënia e komenteve përfundimtare mbi draftin (shtator - tetor 2018)

Ministritë e linjës :

- Rishikimi i politikave, objektivave dhe masave prioritare (maj - shtator 2018), të cilat duhet të përfshijnë të gjitha angazhimet e politikave të ministrive të linjës lidhur me:
 - Programin e Qeverisë,
 - Prioritetet e ML-ve në kuadër të Prioriteteve,
 - Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit,
 - Marrëveshje dhe angazhime të tjera të Qeverisë,
 - Raportet e Komisionit Evropian
 - çdo dokument tjetër strategjik sektorial dhe ndërsektorial ekzistues,
- Hartimi i treguesve (qershor – shtator 2018)

KOMPONENTËT:

Situata aktuale:

1 Qeverisje e hapur për të rritur transparencën e raportimit qeveritar dhe përmirësuar aksesueshmërinë në informacion: Vizioni i strategjisë së reformës të MFP-së është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe

efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik.

Në gjysmën e parë të vitit 2018, MoFE-ja filloi Rishikimin e afatmesëm (MTR) të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020. Objektivat e MTR janë të identifikojnë progresin, arritjet, sfidat dhe boshllëqet për të planifikuar axhendën e ardhshme dhe qasjen SMART në reformën e MFP-se.

Raporti i vlerësimit afatmesëm i strategjisë së MFP-së, ka në përmbajtje një përshkrim të shkurtër të metodologjisë së ndjekur, progresin e secilit komponent të strategjisë sipas shtyllave gjate viteve 2014 deri në gjysmën e parë të vitit 2018; adresimin e rekomandimeve të nxjerra nga raportet e vlerësimit të ndërkombëtarëve; përcaktimin e prioriteteve për çdo shtyllë si dhe përshkrimin e një kuadri të ri në lidhje me rishikimin e strategjisë.

Ministria e Financave, në kuadër të aktiviteteve të Public Finance Management (PFM), përmbushjes së aktiviteteve/dokumentave buxhetor të cilat janë kritere dhe kërkohen nga OBI (Open Budget Index), në mënyrë që informacioni mbi buxhetin të publikohet në kohë, të jetë lehtësisht i aksesueshëm si dhe i qartë edhe për qytetarët, ka ndërmarre për të vazhduar me ecurinë e mëtejshme mbi **Transparencën Buxhetore**.

Transparenca është një nga 8 parimet themelore të “Qeverisjes së mirë” (Good Governance). Sipas OECD-s transparenca buxhetore është përkufizuar si “ zbulim i plotë i të gjitha informacioneve të rëndësishme buxhetore në kohë dhe në mënyrë sistematike”. Transparenca në financat publike është një element kryesor i qeverisjes, e cila çon më tej drejt stabilitetit makroekonomik dhe fiskal, si dhe determinonte për norma më të larta të rritjes ekonomike. Përpos kësaj, ajo ndihmon për të përmirësuar efikasitetin mbi shpenzimet publike, ndërsa rritja e jo transparencës çon drejt zvogëlimit të disiplinës fiskale.

Ministria e Financave i ka kushtuar një vëmendje shumë të madhe transparencës në buxheti, duke e vendosur në një nga prioritetet e saj, të materializuar në Strategjinë e Financave Publike 2014-2020.

Mungesa e transparencës buxhetore sjell: mungesë të disponueshmërisë së informacionit të kërkuar, mungesë informacioni në publik, zvogëlimin e besimit që kanë qytetarët për mënyrën sesi shpenzohen fondet publike, etj. Probleme shfaqen edhe kur kemi mungesë të publikimit të raporteve të monitorimit, raportit të mes-vitit, raportit të fundvitit, “Buxheti i Qytetarit” i cili është një pamflet me gjuhë të thjeshtë, që ilustron aspektet kryesore të buxhetit vjetor, të cilët duhet të publikohen në kohë dhe sigurisht, të kuptueshëm për qytetarët.

Megjithatë, edhe përpos masave të marra në këtë kontekst , Shqipëria, sipas raportit të “Open Budget Survey 2015” rezulton ndër shtete që ka pasur rënie në transparencën e buxhetit të shtetit, e rankuar e parafundit në rajon, me një pikësim me 38 pikë nga 100 të mundshme. Përpos kësaj, është e nevojshme që të avancohet më tej me përmirësimin dhe rritjen e Transparencës Buxhetore.

2 Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe Qeverisjen E-Gov: e-Qeverisja është sot realitet i prekshëm në Shqipëri dhe menaxhohet e koordinohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (më poshtë AKSHI). Që nga viti 2013, AKSHI është kthyer në institucionin më të rëndësishëm sa i përket zhvillimit dhe implementimit të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve elektronike. Nga nëntori i vitit 2017, AKSHI funksionon në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.673, datë 22.11.2017 “Për

Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” mbi bazën e të cilit ofron politika, strategji dhe rregullon sektorin TIK duke përjashtuar fushën e komunikimeve elektronike. Që në fillim kjo agjenci ka pasur si strategji, ndërlidhjen e sistemeve me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale mes tyre, si hap të domosdoshëm për thjeshtimin e shërbimeve dhe uljen e numrit të dokumenteve që i kërkoheshin qytetarit apo biznesit në sportele. Portali qeveritar e-Albania, projekti i qeverisë shqiptare, në themel të të cilit është bashkëveprimi institucional online, është shembulli tipik i dixhitalizimit të shërbimeve shtetërore, ku mundësohen mjete lehtësuese komunikimi të drejtpërdrejta të individëve të autentifikuar në sistem dhe shmangen pengesat e një spektri të gjerë. Qeveria shqiptare, si promotore e transformimit të shërbimeve fizike drejt shërbimeve online, e ktheu e-Albanian në shembull dhe arriti të ndërtojë një imazh serioz të shtetit dhe të kthejë besimin e qytetarëve tek institucionet. Portali qeveritar e-Albania, përmes projekteve të ndryshme ka shtuar në mënyrë të ndjeshme numrin e shërbimeve elektronike, ku në total numërohen 1363 shërbime nga të cilat 590 shërbime elektronike. Portali e-albania është krijuar mbi parimin e Open Government Partnership dhe orientohet nga shërbimi për qytetarin.

Tashmë, një gamë e madhe shërbimesh publike që deri më dje ofroheshin vetëm në modelin tradicional, që kërkonin paraqitje në zyrat përkatëse, aplikim shkresor, pritje në radhë, plotësim formularësh etj., sot merren në rrugë elektronike, me një sportel, nga një aparat telefoni smartphone, një kompjuter në shtëpi. Në këtë kuptim, të gjitha realizimet teknologjike që qëndrojnë pas tij përmbushin këtë synim që në ofrimin e shërbimeve publike që konsistojnë në: thjeshtim procedurash, aplikime elektronike për shërbimet publike, siguri, shpejtësi dhe funksionalitet në maksimumin e kohës dhe çka më shumë rëndësi me akses 24/7 pavarësisht vendndodhjes.

Vlen të theksohet se pas qindra shërbimeve elektronike që sot ofrohen elektronikisht nga institucionet publike shqiptare qëndron një arkitekturë komplekse (Platforma Qeveritare e Ndërveprimit); një proces që vijon i ngritjes së sistemeve të reja, përmirësimit të sistemeve ekzistuese, dixhitalizimit të arkivave fizike, ngritjes së infrastrukturës fizike mbështetëse, ngritjes së platformave të specifikuara ku duhet të qarkullojnë dokumentet e nënshkruara/vulosura elektronikisht, krijimit të kapaciteteve të dedikuara për arkiva elektronike, pajisjes së të gjithë aktorëve me nënshkrim dhe vulë elektronike me qëllim parashikimin dhe përfshirjen e të gjitha hapave dhe hallkave në këtë proces.

Për sa përket Platformës Qeveritare të Ndërveprimit (GG), e cila është arkitektura bazë që mundëson ndërlidhjen e regjistrave elektronikë me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale në formë të sigurt dhe të besueshme, duke garantuar shërbime elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike, si rezultat i investimeve të bëra nga AKSHI gjatë kësaj periudhe, 49 sisteme elektronike janë të lidhura në GG dhe shkëmbejnë të dhëna në kohë reale, në ndryshim nga viti 2013 ku vetëm 6 sisteme elektronike kanë qenë të lidhura në GG.

Një element me rëndësi thelbësore në plotësimin e kornizës së e-Qeverisjes në Shqipëri është që çdo dokument administrativ, si certifikata, vërtetime, dëshmi etj. të kenë të njëjtën vlerë ligjore si kur gjenerohen nga zyrat e shtetit online (apo në këtë rast, nga portali e-albania), ashtu edhe kur merren fizikisht në letër në sportelet e tyre. Ndryshimet ligjore dhe nënligjore përkatëse të miratuara përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 495, datë 13.09.2017, "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike", hapën rrugën e legjitimitit të vulës elektronike, duke i dhënë vlefshmëri ligjore dokumenteve administrative të gjeneruara përmes portalit e-Albania. Në bazë të vendimit, dërgimi dhe pranimi i të dhënave kryhen në përputhje të

plotë me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, ndërsa vulosja e dokumenteve administrative elektronike, të gjeneruara nga transmetimi elektronik, garanton autenticitetin e dokumentit në formatin elektronik. Prej shtatorit 2017 kur u legjitimua vula elektronike, portali e-Albania mundëson shkarkimin e dokumenteve administrative me vlerë ligjore 24/7, duke i bërë këto dokumente të disponueshme në çdo orë të ditës dhe në çdo ditë të javës, pavarësisht orarit të hapjes së sporteleve shtetërore. Aktualisht në portal ofrohen 33 dokumente me vulë elektronike, një pjesë prej së cilave ofrohen vetëm elektronikisht, duke eliminuar tërësisht printimin e tyre në letër në sportelet fizike të institucioneve.

Përpos vulës elektronike, risia tjetër është përdorimi i portalit e-Albania për punonjësit e administratës publike për të marrë vërtetime dhe dokumente të cilat gjenden si shërbime të portalit për plotësimin e dokumentacionit shoqëruar të shërbimit të kërkuar nga qytetari dhe nuk do t'i kërkojnë më vetë atij. Sot, është punonjësi i administratës publike dhe jo qytetari, ai që ka detyrën e mbledhjes së dokumenteve me vulë elektronike nga portali e-albania dhe bashkëlidhjes së tyre në dosjen e aplikimit të qytetarit. E thënë më thjesht: itinerari i zakonshëm nga zyra në zyrë për një certifikatë, vërtetim etj., ka marrë fund.

Mbi 2.6 milionë dokumente me vulë elektronike janë përfituar lehtësisht nga qytetarët dhe bizneset, duke shmangur përfundimisht korrupsionin dhe vonesat.

Janë këto ritme që po sjellin një transformim, nga ku vijnë përfitime jo vetëm për institucionet shtetërore por sidomos për qytetarët dhe biznesin, të cilët po përfitojnë me anë të këtij procesi dhe shërbimeve të ngritura.

Këto zhvillime kanë ndikuar në përmirësimin e Indeksit të Zhvillimit të e-Qeverisjes (EGDI) i cili është një index që vlerëson zhvillimin e e-qeverisjes në nivel kombëtar. Në vitin 2016 Shqipëria renditej e 82-ta nga 193 vende për sa i përket indeksit EGDI me një vlerë 0.5331. Në vitin 2018 Shqipëria renditet e 74-ta midis shteteve si Hungaria, Bullgaria, Kroacia, etj. me vlerë të indeksit 0.6519. Nga tre komponentët e EGDI, sipas raportit ndikimin më të madh në rritjen e tij e ka pasur komponenti Indeksit të Shërbimeve Online (OSI) me një vlerë 0.7361 në vitin 2018, krahasuar me 0.5942 në vitin 2016. Indikatorin e-Pjesëmarrja (EPI) është në nivelin 0.7584, duke bërë që Shqipëria të afrohet me shtete si Australia, Austria, Belgjika, etj., me indeksin e e-pjesëmarrjes "Shumë të lartë", nga i "Lartë" e klasifikuar në vitin 2016.

Shqipëria ka ecur më shpejt krahasimisht me kohënisjen e procesit dhe zgjerimin progresiv të shërbimeve që tashmë ofrohen në formën elektronike, apo ndërlidhjen e sistemeve.

Në këtë kuadër AKSHI ka vijuar punën për identifikimin e shërbimeve të reja publike që do të dixhitalizohen, për shtimin dhe promovimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të iniciativës Open Government Partnership.

Qeveria shqiptare është e angazhuar për të punuar për një qeverisje më të mirë, cilësore, të hapur dhe transparente. Transparenca është një nga tre prioritetet kyçe, të përcaktuara së fundmi nga udhëheqësit e vendeve të G8. Ata nënshkruan në qershor 2013 disa parime të specifikuara për "Open Data", në dokumentin "Open Data Charter". Të dhënat e hapura mbështesin dhe inkurajojnë inovacionin dhe sigurojnë një përgjegjshmëri më të madhe për përmirësimin e demokracisë.

Të dhënat janë të fuqishme, ato ndikojnë në transparencë dhe ndihmojnë në kontrollin e saktë të çdo aktiviteti. Shumë vende kanë nisur programe transparence ndaj qeverive dhe zyrave publike nëpërmjet publikimit të të dhënave "Open Data" në internet. Politikat për zhvillimin e të dhënave të hapura kanë marrë një zhvillim të shpejtë në pesë vitet e fundit në vende të ndryshme. Iniciativat për realizimin e open data janë të formave të ndryshme në vende të ndryshme duke filluar nga

zhvillimet e portaleve e të dhënave të veçanta në kuadër të zhvillimit të e-qeverisjes drejt projekteve më ambicioze për të pasur realisht “open data”. Bashkimi Evropian ka adoptuar disa dokumente për implementimin e “Open Data” dhe ka krijuar portalin për të dhëna të hapura në nivel BE-je. Shumë vende kanë adoptuar planet e veprimit dhe politikat kombëtare për realizimin e të dhënave të hapura.

Në fakt, me rritjen e kërkesave nga publiku për një qeverisje transparente dhe llogaridhënese dhe përpjekjeve të vazhdueshme të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të siguruar një komunikim më të mirë dhe të hapur me qytetarët dhe me shoqërinë civile, AKSHI, gjithashtu në kuadër të kësaj iniciative globale, në vitin 2016 ka implementuar Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Implementimi i të dhënave të hapura dhe krijimi i portalit qeveritar për të dhënat e hapura është një angazhim i rëndësishëm i qeverisë, pjesë e planit të veprimit të hartuar në kuadër të iniciativës globale për Open Government Partnership (OGP).

Për sa më lart, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), bazuar në Ligjin Nr. 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”, si dhe Ligjin Nr. 146/2014 datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, angazhohet në ndërtimin e portalit opendata.gov.al, i cili nëpërmjet tre moduleve kryesore të tij, do të shërbejë si një dritare informuese për ecurinë e projektit OGP për Shqipërinë, si një vend konsultimi mes qytetarëve dhe institucioneve vendimmarrëse në Shqipëri, si edhe si një pikë unike e publikimit të të dhënave të hapura qeveritare.

Qëllimi kryesor i implementimit të ‘open data’ është një qeverisje më efëcente dhe efektive, rritje ekonomike dhe inovacion, transparencë dhe përgjegjëshmëri, promovimi i ripërdorimit të informacionit publik duke respektuar të drejtën e pronësisë intelektuale dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Përmes krijimit të portalit qeveritar për të dhënat e hapura, synohet rritje e transparencës dhe rritje e angazhimit publik në qeverisje.

3 Qeverisje e hapur për ‘Better Regulation Hartimi i politikave dhe strategjive bazohet në Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI). SPI është sistemi kyç kombëtar i vendimmarrjes për përcaktimin e drejtimeve strategjike dhe shpërndarjen e burimeve (Banka Botërore i referohet SPI shqiptare si një prej praktikave më të mira në rajon). Qëllimi kryesor i SPI-së është hartimi i një plani strategjik, të integruar, strukturor dhe të përgjegjshëm për Shqipërinë, duke përfshirë këtu edhe harmonizimin e përshtatjen e sistemeve ekzistuese të planifikimit dhe monitorimit brenda sistemit të ri dhe riorganizimin e strukturave sipas sistemit të ri. SPI synon të shmangë hartimin e politikave dhe strategjive ad hoc, të shmangë mbivendosjen mes tyre dhe të sigurojë përputhjen me proceset e planifikimit financiar.

Kuadri institucional i SPI është konsoliduar më tej me ristrukturimin e institucionit të Kryeministrit dhe forcimin e kapaciteteve të monitorimit dhe të planifikimit strategjik në këtë institucion, nëpërmjet krijimit të Njesisë së Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dhe Njesisë së Programimit të Akteve Rregullatore pranë Departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë.

Për komponentë të ndryshëm të SPI janë duke u ngritur sisteme informacioni. Që prej vitit 2007 funksionon për të gjitha ministritë e linjës sistemi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), ndërkohë që do të ngrihet Sistemi i Informacionit Financiar Qeveritar (AFMIS), Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Ndihmës së Huaj (EAMIS) dhe Sistemi i Informacionit për Sistemin e Integruar të Planifikimit (IPSIS). Lidhur me procesin legjislativ dhe cilësinë e

legjislacionit, ka përpjekje për përmirësimin e analizave, planifikimin e masave dhe përmbushjen e tyre. Në përgjithësi procesi i hartimit të legjislacionit është shoqëruar me transparencë të pamjaftueshme dhe ka munguar konsultimi me palët e interesuara. Në vitin 2014 është miratuar ligji për konsultimin publik të akteve politike dhe legjislativë si dhe një ligj i ri për të drejtën e informimit, për të cilët duhen marrë masat e nevojshme për zbatimin e plotë e cilësor. Në pak raste ka pasur vlerësime të mirëfillta ex ante dhe ex post të pasojave të legjislacionit.

Sfidat:

Konsolidimi i kuadrit të Sistemit të Planifikimit të Integruar mbetet ende një sfide. Për më tepër, është i nevojshëm konsolidimi i kapaciteteve të strukturave të reja në lidhje me funksionimin si një i tërë i krejt mekanizmave të sistemit. Rritja e eficiencës të sistemit nevojitet të adresohet përmes konsolidimit të tij.

Ngritja e sistemeve të informacionit për komponentët e SPI-së kërkon një zbatim të qartë të proceseve të punës (business core processes) lidhur me planifikimin e politikave, buxhetit dhe investimeve. Nga ana tjetër, ngritja e kapaciteteve të institucioneve të përfshira është e dosmosdoshme.

Në drejtim të përmirësimit të sistemit mirërregullator:

- Politikat synojnë forcimin e sistemit të planifikimit të integruar, monitorimit të politikave dhe legjislacionit, raportimit dhe vlerësimit, që i shndërron prioritetet e qeverisë në veprime konkrete; rritjen e transparencës për dokumentet strategjike të qeverisë dhe monitorimin e tyre; rritjen e kapaciteteve të ministrive për hartuar politika dhe legjislacion të mirë në përputhje me acquis.

Politikat gjithashtu në këtë sektor do të synojnë rritjen e eficiencës në planifikimin strategjik dhe monitorimin e performancës së politikave të zbatuara; ngritjen e sistemeve të informacionit për sistemet e planifikimit të politikave dhe financave publike; ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit horizontal midis ministrive, si edhe brenda ministrive të linjës; si edhe krijimin e mekanizmave të kontrollit të efektshmërisë së legjislacionit.

Qeverisje e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta: Korrupsioni është pengesa kryesore në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror të shteteve. Në vitin 2013, Shqipëria shënoi sërish për të tretin vit radhazi vendin e fundit, nga vendet e rajonit në renditjen e indeksit global të perceptimit të korrupsionit duke marrë kështu damkën si vendi më i korruptuar në Evropë. Ulje – ngritjet e perceptimit publik në 10 vitet e fundit, objektivist, përkojnë me reformat e kryera ose të munguara të qeverisjes. Për këtë arsye, qeveria e konsideron perceptimin e publikut mbi korrupsionin jo vetëm si tregues për gjendjen reale të tij (të korrupsionit) por edhe si masë për suksesin apo dështimin e politikave dhe programeve të qeverisë në luftën kundër korrupsionit.

Përkundrejt këtij sfondi faktesh dhe kësaj vetëdije politike e shoqërore, me objektivin përfundimtar të modernizimit të qeverisjes në vend, qeveria angazhohet për luftë pa kompromis dhe zero tolerancë kundër korrupsionit duke i dhënë kësaj politike publike përparësinë që meriton.

Përparësia e qeverisë në këtë fushë, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritetit evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Në përgjigje të nevojave të vendit për zhvillim, dhe pritshmërive të ligjshme të publikut dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, qeveria synon të ndërmarrë një përpjekje në luftën kundër korrupsionit e cila të përfshijë një qasje të trefishtë parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese. Angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e përcaktuara janë në linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe rekomandimet e KE-së për Shqipërinë për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Korrupsioni dhe luftimi i tij vijojnë të jenë një nga sfidat kryesore dhe një nga prioritetet madhore ndërsektoriale për Shqipërinë. Gjatë viteve 2007-2010 reformat e ndërmarra nga qeveria kanë synuar modernizimin e administratës shtetërore dhe proceset e saj të punës, duke kontribuar kështu në parandalimin e korrupsionit në fusha ku korrupsioni ishte në nivele tepër të larta dhe ku ndikimi mbi ekonominë e vendit ishte i ndjeshëm.

Kështu përmes reformave rregullatore në fushën e auditimit, krijimi i sistemit të prokurimit elektronik me qëllim rritjen e transparencës në fushën e prokurimeve publike, u shënuar rritje e performancës së qeverisë në këto fusha, çka evidentohet edhe nga treguesit e përbërë të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare. Po kështu, krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve, Qendrës Kombëtare të Licencimit të Bizneseve, si dhe ngritja e sistemeve të E-tatimeve dhe E-doganave, ka lehtësuar ndjeshëm procedurat administrative përkatëse dhe ka reduktuar kontaktet personale të përdoruesve/kërkuesve të shërbimit me administratën, si dhe ka kontribuar në uljen e nivelit të korrupsionit në këta sektorë.

Komponenti I: Qeverisje e hapur për të rritur transparencën e raportimit qeveritar dhe përmirësuar aksesueshmërinë në informacion

Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe eficiencën në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe zhvillimin ekonomik.

| KOMPONENTI I: QEVERISJE E HAPUR PËR TË RRITUR TRANSPARENCËN E RAPORTIMIT QEVERITAR DHE PËRMIRËSUAR AKSESUESHMËRINË NË INFORMACION | | |
|--|-----------------------------------|---|
| Institucioni udhëheqës | | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| Pjesëmarrës të tjerë | Qeveria | Kryeministria, Ministria e Europes dhe Punëve të Jashtme, Agjensia e Prokurimeve Publike, Komisioni i Prokurimit Publik, Kontrolli i Lartë i Shtetit, INSTAT, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtorite e Përgjithshme e Doganave |
| | Shoqëria Civile Sektori privat | |
| Status quo ose problemi/çështja që adresohet | | <p>Vizioni i strategjisë së reformës të MFP-së është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik.</p> <p>Në gjysmën e parë të vitit 2018, MoFE-ja filloi Rishikimin e afatmesëm (MTR) të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020. Objektivat e MTR janë të identifikojnë progresin, arritjet, sfidat dhe boshllëqet për të planifikuar axhendën e ardhshme dhe qasjen SMART në reformën e MFP-se.</p> <p>Raporti i vlerësimit afatmesëm i strategjisë së MFP-së, ka në përmbajtje një përshkrim të shkurtër të metodologjisë së ndjekur, progresin e secilit komponent të strategjisë sipas shtyllave gjate viteve 2014 deri në gjysmën e parë të vitit 2018; adresimin e rekomandimeve të nxjerra nga raportet e vlerësimit të ndërkombëtarëve; përcaktimin e prioriteteve për çdo shtyllë si dhe përshkrimin e një kuadri të ri në lidhje me rishikimin e strategjisë.</p> <p>Ministria e Financave, në kuadër të aktiviteteve të Public Finance Management (PFM), përmbushjes së aktiviteteve/dokumentave buxhetor të cilat janë kritere dhe kërkohen nga OBI (Open Budget Index), në mënyrë që informacioni mbi buxhetin të publikohet në kohë, të jetë lehtësisht i aksesueshëm si dhe i qartë edhe për qytetarët, ka ndërmarre për të vazhduar me ecurinë e mëtejshme mbi Transparencën Buxhetore.</p> <p>Transparenca është një nga 8 parimet themelore të “Qeverisjes së mirë” (Good Governance). Sipas OECD-s transparenca buxhetore është përkufizuar si “ zbulim i plotë i të gjitha informacioneve të rëndësishme buxhetore në kohë dhe në mënyrë sistematike”. Transparenca në financat publike është një element kryesor i qeverisjes, e cila çon më tej drejt stabilitetit makroekonomik dhe fiskal, si dhe determinonte për norma më të larta të rritjes ekonomike. Përpos kësaj, ajo ndihmon për të përmirësuar</p> |

| | | | | | | |
|---|--|---|---|---|--|---------------------------------------|
| | | <p>efikasitetin mbi shpenzimet publike, ndërsa rritja e jo transparencës çon drejt zvogëlimit të disiplinës fiskale.</p> <p>Ministria e Financave i ka kushtuar një vëmendje shumë të madhe transparencës në buxheti, duke e vendosur në një nga prioritetet e saj, të materializuar në Strategjinë e Financave Publike 2014-2020.</p> <p>Mungesa e transparencës buxhetore sjell: mungesë të disponeshmërisë së informacionit të kërkuar, mungesë informacioni në publik, zvogëlimin e besimit që kanë qytetarët për mënyrën sesi shpenzohen fondet publike, etj. Probleme shfaqen edhe kur kemi mungesë të publikimit të raporteve të monitorimit, raportit të mes-vitit, raportit të fundvitit, “Buxheti i Qytetarit” i cili është një pamflet me gjuhë të thjeshtë, që ilustron aspektet kryesore të buxhetit vjetor, të cilët duhet të publikohen në kohë dhe sigurisht, të kuptueshëm për qytetarët.</p> <p>Megjithatë, edhe përpos masave të marra në këtë kontekst, Shqipëria, sipas raportit të “Open Budget Survey 2015” rezulton ndër shtete që ka pasur rënie në transparencën e buxhetit të shtetit, e rankuar e parafundit në rajon, me një pikësim me 38 pikë nga 100 të mundshme. Përpos kësaj, është e nevojshme që të avancohet më tej me përmirësimin dhe rritjen e Transparencës Buxhetore.</p> | | | | |
| Objektivi kryesor/ Qëllimi i politikës | | Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe eficiencën në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe zhvillimin ekonomik. | | | | |
| Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi | | Përmirësim i shërbimeve publike | Administrimi më efikas i burimeve publike | Rritja e integritetit publik | Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave | Krijimi i një komuniteti më të sigurt |
| | | X | X | X | | |
| Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e: | | Transparenca | Përgjegjësi | Pjesëmarrjes qytetare | | Teknologji dhe inovacion |
| | | X | X | | | |
| Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit | Indikatorët e Rezultatit | Indikatorët e Outputit | Institucion i Përgjegjës | Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2016-2018 | Data e fillimit | Data e mbarimit |
| 1.1 Krijimi i një sistemi të plotë statistikor që mbulon nevojat e subjekteve buxhetore dhe gjysmë-buxhetore. | 1. Sistemi statistikor i përmirësuar 2. Modeli standard i hatruar | Përpilimi i Llogarive Kombëtare Qeveritare sipas metodologjive | INSTAT | Angazhim i vazhduar | 2014 | 2022 |

| | | | | | | |
|---|---|--|-----|---------------------|------|------|
| 1.2 Krijimi i informacionit të standardizuar | | Ndërkombëtare (ESA 2010 dhe GFS 2014) | | | | |
| 1.3 Krijimi i metodave alternative për grumbullimin e informacionit | 1. Metodatat e reja të zhvilluara për shkëmbimin e të dhënave 3. Formatet / modelet e standardeve 4. Raporti mbi rezultatet e miratuara | | | | | |
| 1.4 Integrimi i Informacionit Shtesë mbi Sistemin e Thesarit (AGFIS) | | | | | | |
| 1.5 Integrimi në Template të reja për shkëmbimin e informacionit | | | | | | |
| 1.6 Krahasoni rezultatet dhe miratoni informacione të reja | | | | | | |
| 1.7 Hartimi i një deklarate të detajuar të rreziqeve fiskale dhe përfshirja në dokumentacionin e buxhetit | Deklarata e risqeve fiskale | | MFE | Angazhim i vazhduar | 2014 | 2022 |
| 1.8 Monitorimi i institucioneve publike në lidhje me zbatimin e kërkesave të MFK | Kërkesave të MFK të zbatuara | Të gjitha njësitë buxhetore do të përdorin kërkesat e Kontrollit të Brendshëm Financiar për të përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm dhe për të arritur objektivat dhe rezultatet | MFE | Angazhim i vazhduar | 2014 | 2022 |
| 1.9 Zbatimi i mjeteve të MFK në njësitë e sektorit publik | | | | | | |

Komponenti II: Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe Qeverisjen E-Gov

Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është Zhvillimi i qeverisjes elektronike dhe ofrimi i shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset.

| KOMPONENTI II: QEVERISJE E HAPUR PËR TË MODERNIZUAR SHËRBIMET PUBLIKE DHE QEVERISJEN E-GOV | | |
|---|---|---|
| Institucioni udhëheqës | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit | |
| Pjesëmarrës të tjerë | Qeveria | Ministritë e Linjës dhe institucione e tyre te varësisë, pushteti lokal, institucionet e pavarura |
| | Shoqëria Civile Sektori privat | Qytetarët/biznesi/punonjësit e administratës publike |
| Status quo ose problemi/çështja që adresohet | <p>e-Qeverisja është sot realitet i prekshëm në Shqipëri dhe menaxhohet e koordinohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (më poshtë AKSHI). Që nga viti 2013, AKSHI është kthyer në institucionin më të rëndësishëm sa i përket zhvillimit dhe implementimit të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve elektronike. Nga nëntori i vitit 2017, AKSHI funksionon në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” mbi bazën e të cilit ofron politika, strategji dhe rregullon sektorin TIK duke përjashtuar fushën e komunikimeve elektronike. Që në fillim kjo agjenci ka pasur si strategji, ndërlikdhjen e sistemeve me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale mes tyre, si hap të domosdoshëm për thjeshtimin e shërbimeve dhe uljen e numrit të dokumenteve që i kërkoheshin qytetarit apo biznesit në sportele.</p> <p>Portali qeveritar e-Albania, projekti i qeverisë shqiptare, në themel të të cilit është bashkëveprimi institucional online, është shembulli tipik i dixhitalizimit të shërbimeve shtetërore, ku mundësohen mjete lehtësuese komunikimi të drejtpërdrejta të individëve të autentifikuar në sistem dhe shmangen pengesat e një spektri të gjerë. Qeveria shqiptare, si promotore e transformimit të shërbimeve fizike drejt shërbimeve online, e ktheu e-Albanian në shembull dhe arriti të ndërtojë një imazh serioz të shtetit dhe të kthejë besimin e qytetarëve tek institucionet. Portali qeveritar e-Albania, përmes projekteve të ndryshme ka shtuar në mënyrë të ndjeshme numrin e shërbimeve elektronike, ku në total numërohen 1363 shërbime nga të cilat 590 shërbime elektronike. Portali e-albania është krijuar mbi parimin e Open Government Partnership dhe orientohet nga shërbimi për qytetarin.</p> <p>Tashmë, një gamë e madhe shërbimesh publike që deri më dje ofroheshin vetëm në modelin tradicional, që kërkonin paraqitje në zyrat përkatëse, aplikim shkresor, pritje në radhë, plotësim formularësh etj., sot merren në rrugë elektronike, me një sportel, nga një aparat telefoni smartphone, një kompjuter në shtëpi. Në këtë kuptim, të gjitha realizimet teknologjike që qëndrojnë pas tij përmbushin këtë synim që në ofrimin e shërbimeve</p> | |

publike që konsistojnë në: thjeshtim procedurash, aplikime elektronike për shërbimet publike, siguri, shpejtësi dhe funksionalitet në maksimumin e kohës dhe çka më shumë rëndësi me akses 24/7 pavarësisht vendndodhjes.

Vlen të theksohet se pas qindra shërbimeve elektronike që sot ofrohen elektronikisht nga institucionet publike shqiptare qëndron një arkitekturë komplekse (Platforma Qeveritare e Ndërveprimit); një proces që vijon i ngritjes së sistemeve të reja, përmirësimit të sistemeve ekzistuese, dixhitalizimit të arkivave fizike, ngritjes së infrastrukturës fizike mbështetëse, ngritjes së platformave të specifikuara ku duhet të qarkullojnë dokumentet e nënshkruara/vulosura elektronikisht, krijimit të kapaciteteve të dedikuara për arkiva elektronike, pajisjes së të gjithë aktorëve me nënshkrim dhe vulë elektronike me qëllim parashikimin dhe përfshirjen e të gjitha hapave dhe hallkave në këtë proces.

Për sa përket Platformës Qeveritare të Ndërveprimit (GG), e cila është arkitektura bazë që mundëson ndërlidhjen e regjistrave elektronikë me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale në formë të sigurt dhe të besueshme, duke garantuar shërbime elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike, si rezultat i investimeve të bëra nga AKSHI gjatë kësaj periudhe, 49 sisteme elektronike janë të lidhura në GG dhe shkëmbejnë të dhëna në kohë reale, në ndryshim nga viti 2013 ku vetëm 6 sisteme elektronike kanë qenë të lidhura në GG.

Një element me rëndësi thelbësore në plotësimin e kornizës së e-Qeverisjes në Shqipëri është që çdo dokument administrativ, si certifikata, vërtetime, dëshmi etj. të kenë të njëjtën vlerë ligjore si kur gjenerohen nga zyrat e shtetit online (apo në këtë rast, nga portali e-albania), ashtu edhe kur merren fizikisht në letër në sportelet e tyre. Ndryshimet ligjore dhe nënligjore përkatëse të miratuara përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 495, datë 13.09.2017, "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike", hapën rrugën e legjitimitetit të vulës elektronike, duke i dhënë vlefshmëri ligjore dokumenteve administrative të gjeneruara përmes portalit e-Albania. Në bazë të vendimit, dërgimi dhe pranimi i të dhënave kryhen në përputhje të plotë me legjislationin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, ndërsa vulosja e dokumenteve administrative elektronike, të gjeneruara nga transmetimi elektronik, garanton autenticitetin e dokumentit në formatin elektronik. Prej shtatorit 2017 kur u legjitimua vula elektronike, portali e-Albania mundëson shkarkimin e dokumenteve administrative me vlerë ligjore 24/7, duke i bërë këto dokumente të disponueshme në çdo orë të ditës dhe në çdo ditë të javës, pavarësisht orarit të hapjes së sporteleve shtetërore. Aktualisht në portal ofrohen 33 dokumente me vulë elektronike, një pjesë prej së cilave ofrohen vetëm elektronikisht, duke eliminuar tërësisht printimin e tyre në letër në sportelet fizike të institucioneve.

Përpos vulës elektronike, risia tjetër është përdorimi i portalit e-Albania për punonjësit e administratës publike për të marrë vërtetime dhe dokumente të cilat gjenden si shërbime të portalit për plotësimin e dokumentacionit shoqëruar të shërbimit të kërkuar nga qytetari dhe nuk do t'i kërkohej më vetë atij. Sot, është punonjësi i administratës publike dhe jo qytetari, ai që ka detyrën e mbledhjes së dokumenteve me vulë

elektronike nga portali e-albania dhe bashkëlidhjes së tyre në dosjen e aplikimit të qytetarit. E thënë më thjesht: itinerari i zakonshëm nga zyra në zyrë për një certifikatë, vërtetim etj., ka marrë fund.

Mbi 2.6 milionë dokumente me vulë elektronike janë përfituar lehtësisht nga qytetarët dhe bizneset, duke shmangur përfundimisht korrupsionin dhe vonesat.

Janë këto ritme që po sjellin një transformim, nga ku vijnë përfitime jo vetëm për institucionet shtetërore por sidomos për qytetarët dhe biznesin, të cilët po përfitojnë me anë të këtij procesi dhe shërbimeve të ngritura.

Këto zhvillime kanë ndikuar në përmirësimin e Indeksit të Zhvillimit të e-Qeverisjes (EGDI) i cili është një index që vlerëson zhvillimin e e-qeverisjes në nivel kombëtar. Në vitin 2016 Shqipëria renditej e 82-ta nga 193 vende për sa i përket indeksit EGDI me një vlerë 0.5331. Në vitin 2018 Shqipëria renditet e 74-ta midis shteteve si Hungaria, Bullgaria, Kroacia, etj. me vlerë të indeksit 0.6519. Nga tre komponentët e EGDI, sipas raportit ndikimin më të madh në rritjen e tij e ka pasur komponenti Indeksit të Shërbimeve Online (OSI) me një vlerë 0.7361 në vitin 2018, krahasuar me 0.5942 në vitin 2016. Indikatori e-Pjesëmarrja (EPI) është në nivelin 0.7584, duke bërë që Shqipëria të afrohet me shtete si Australia, Austria, Belgjika, etj., me indeksin e e-pjesëmarrjes “Shumë të lartë”, nga i “Lartë” e klasifikuar në vitin 2016.

Shqipëria ka ecur më shpejt krahasimisht me kohënisjen e procesit dhe zgjerimin progresiv të shërbimeve që tashmë ofrohen në formën elektronike, apo ndërlidhjen e sistemeve.

Në këtë kuadër AKSHI ka vijuar punën për identifikimin e shërbimeve të reja publike që do të dixhitalizohen, për shtimin dhe promovimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të iniciativës Open Government Partnership.

Qeveria shqiptare është e angazhuar për të punuar për një qeverisje më të mirë, cilësore, të hapur dhe transparente. Transparenca është një nga tre prioritetet kyçe, të përcaktuara së fundmi nga udhëheqësit e vendeve të G8. Ata nënshkruan në qershor 2013 disa parime të specifikuar për “Open Data”, në dokumentin “Open Data Charter”. Të dhënat e hapura mbështesin dhe inkurajojnë inovacionin dhe sigurojnë një përgjegjshmëri më të madhe për përmirësimin e demokracisë.

Të dhënat janë të fuqishme, ato ndikojnë në transparencë dhe ndihmojnë në kontrollin e saktë të çdo aktiviteti. Shumë vende kanë nisur programe transparence ndaj qeverive dhe zyrave publike nëpërmjet publikimit të të dhënave "Open Data" në internet. Politikat për zhvillimin e të dhënave të hapura kanë marrë një zhvillim të shpejtë në pesë vitet e fundit në vende të ndryshme. Iniciativat për realizimin e open data janë të formave të ndryshme në vende të ndryshme duke filluar nga zhvillimet e portaleve e të dhënave të veçanta në kuadër të zhvillimit të e-qeverisjes drejt projekteve më ambicioze për të pasur realisht “open data”. Bashkimi Evropian ka adoptuar disa dokumente për implementimin e “Open Data” dhe ka krijuar portalin për të dhëna të hapura në nivel BE-je. Shumë vende kanë adoptuar planet e veprimit dhe politikat kombëtare për realizimin e të dhënave të hapura.

| | | | | | | |
|--|--------------------------|---|---|---|---|---------------------------------------|
| | | <p>Në fakt, me rritjen e kërkesave nga publiku për një qeverisje transparente dhe llogaridhënese dhe përpjekjeve të vazhdueshme të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të siguruar një komunikim më të mirë dhe të hapur me qytetarët dhe me shoqërinë civile, AKSHI, gjithashtu në kuadër të kësaj iniciative globale, në vitin 2016 ka implementuar Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.</p> <p>Implementimi i të dhënave të hapura dhe krijimi i portalit qeveritar për të dhënat e hapura është një angazhim i rëndësishëm i qeverisë, pjesë e planit të veprimit të hartuar në kuadër të iniciativës globale për Open Government Partnership (OGP).</p> <p>Për sa më lart, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), bazuar në Ligjin Nr. 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”, si dhe Ligjin Nr. 146/2014 datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, angazhohet në ndërtimin e portalit opendata.gov.al, i cili nëpërmjet tre moduleve kryesore të tij, do të shërbejë si një dritare informuese për ecurinë e projektit OGP për Shqipërinë, si një vend konsultimi mes qytetarëve dhe institucioneve vendimmarrëse në Shqipëri, si edhe si një pikë unike e publikimit të të dhënave të hapura qeveritare.</p> <p>Qëllimi kryesor i implementimit të ‘open data’ është një qeverisje më efiçente dhe efektive, rritje ekonomike dhe inovacion, transparencë dhe përgjegjshmëri, promovimi i ripërdorimit të informacionit publik duke respektuar të drejtën e pronësisë intelektuale dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Përmes krijimit të portalit qeveritar për të dhënat e hapura, synohet rritje e transparencës dhe rritje e angazhimit publik në qeverisje.</p> | | | | |
| Objektivi kryesor/ Qëllimi i politikës | | Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është zhvillimi i qeverisjes elektronike dhe ofrimi i shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset. | | | | |
| Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi | | Përmirësi mi shërbimeve publike | Administrimi më efikas i burimeve publike | Rritja e integritetit publik | Rritja e përgjegjsh mërisë së korporatave | Krijimi i një komuniteti më të sigurt |
| | | X | X | X | X | |
| Është e rëndësishme për përmirësimin e: | | Transparenca | Përgjegjësi së | Pjesëmarrjes qytetare | | Teknologji dhe inovacion |
| | | X | X | X | | X |
| Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit | Indikatorët e Rezultatit | Indikatorët e Outputit | Institucion i Përgjegjës | Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2016-2018 | Data e fillimit | Data e mbarimit |
| 2.1.1 Zhvillimi i Seksionit informativ mbi Partneritetin për | Portali Open Data | Rritja e angazhimit publik | AKSHI, ML/Agjencitë | Angazhim i ri | 2018 | 2019 |

| | | | | | | |
|--|---|---|---------------------|-----------|------|------|
| Qeverisjen e Hapur (PQH-OGP) | | në qeverisje | | | | |
| 2.1.2 Zhvillimi i Seksionit “Open Data” për transparencë mbi aktivitetin e institucioneve publike | | | | | | |
| 2.1.3 Identifikimi dhe mbledhja e të dhënave në formatin e duhur nga institucionet e administratës publike | | Përmirësimi i evidencave me qëllim përmirësimin e politikave dhe rritjen e transparencës qeveritare | | | | |
| 2.1.4 Integrimi i të dhënave në portal | | | | | | |
| 2.2.11 Implementimi i shërbimeve të reja elektronike në portalin e-Albania | Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në portalin e-Albania | Rritja e aksesit ndaj shërbimeve publike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike | AKSHI, ML/Agjencitë | Angazhimi | 2019 | 2020 |
| 2.2.2 Ekspozime të dhënash në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit | | Reduktimi i burokracive, kostos dhe kohës ndaj qytetarëve dhe bizneseve | | | | |

Komponenti III: “Qeverisje e hapur për ‘Better Regulation’”

Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime më cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive, dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative, dhe përputhet me kërkesat e integritit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave eficiente.

| KOMPONENTI III: QEVERISJE E HAPUR PËR “BETTER REGULATION” | | |
|--|--|---|
| Institucioni udhëheqës | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, KM | |
| Pjesëmarrës të tjerë | Qeveria | Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Ministrinë e Linjës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| | Shoqëria Civile Sektori privat | Partnerët për Ndryshim dhe Zhvillim në Shqipëri, Institutiti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Fondacioni “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”, Instituti për Promovimin e Zhvillimit Social Ekonomik |
| Status quo ose problemi/çështja që adresohet | <p>Hartimi i politikave dhe strategjive bazohet në Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI). SPI është sistemi kyç kombëtar i vendimmarrjes për përcaktimin e drejtimeve strategjike dhe shpërndarjen e burimeve (Banka Botërore i referohet SPI shqiptare si një prej praktikave më të mira në rajon). Qëllimi kryesor i SPI-së është hartimi i një plani strategjik, të integruar, strukturor dhe të përgjegjshëm për Shqipërinë, duke përfshirë këtu edhe harmonizimin e përshtatjen e sistemeve ekzistuese të planifikimit dhe monitorimit brenda sistemit të ri dhe riorganizimin e strukturave sipas sistemit të ri. SPI synon të shmangë hartimin e politikave dhe strategjive ad hoc, të shmangë mbivendosjen mes tyre dhe të sigurojë përputhjen me proceset e planifikimit financiar.</p> <p>Kuadri institucional i SPI është konsoliduar më tej me ristrukturimin e institucionit të Kryeministrit dhe forcimin e kapaciteteve të monitorimit dhe të planifikimit strategjik në këtë institucion, nëpërmjet krijimit të Njësisë së Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje dhe Njësisë së Programimit të Akteve Rregullatore pranë Departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë.</p> <p>Për komponentë të ndryshëm të SPI janë duke u ngritur sisteme informacioni. Që prej vitit 2007 funksionon për të gjitha ministrinë e linjës sistemi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), ndërkohë që do të ngrihet Sistemi i Informacionit Financiar Qeveritar (AFMIS), Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e</p> | |

| | | | | | |
|--|---|--|-------------------------------------|---|--|
| | <p>Ndihmës së Huaj (EAMIS) dhe Sistemi i Informacionit për Sistemin e Integruar të Planifikimit (IPSIS). Lidhur me procesin legjislativ dhe cilësinë e legjislacionit, ka përpjekje për përmirësimin e analizave, planifikimin e masave dhe përmbushjen e tyre. Në përgjithësi procesi i hartimit të legjislacionit është shoqëruar me transparencë të pamjaftueshme dhe ka munguar konsultimi me palët e interesuara. Në vitin 2014 është miratuar ligji për konsultimin publik të akteve politike dhe legjislative si dhe një ligj i ri për të drejtën e informimit, për të cilët duhen marrë masat e nevojshme për zbatimin e plotë e cilësor. Në pak raste ka pasur vlerësime të mirëfillta ex ante dhe ex post të pasojave të legjislacionit.</p> <p>Sfidat:</p> <p>Konsolidimi i kuadrit të Sistemit të Planifikimit të Integruar mbetet ende një sfidë. Për më tepër, është i nevojshëm konsolidimi i kapaciteteve të strukturave të reja në lidhje me funksionimin si një i tërë i krejt mekanizmave të sistemit. Rritja e eficiencës të sistemit nevojitet të adresohet përmes konsolidimit të tij. Ngritja e sistemeve të informacionit për komponentët e SPI-së kërkon një zbatim të qartë të proceseve të punës (business core processes) lidhur me planifikimin e politikave, buxhetit dhe investimeve. Nga ana tjetër, ngritja e kapaciteteve të institucioneve të përfshira është e dosmosdoshme.</p> <p>Në drejtim të përmirësimit të sistemit mirërregullator:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Politikat synojnë forcimin e sistemit të planifikimit të integruar, monitorimit të politikave dhe legjislacionit, raportimit dhe vlerësimit, që i shndërron prioritetet e qeverisë në veprime konkrete; rritjen e transparencës për dokumentet strategjike të qeverisë dhe monitorimin e tyre; rritjen e kapaciteteve të ministrive për hartuar politika dhe legjislacion të mirë në përputhje me acquis. <p>Politikat gjithashtu në këtë sektor do të synojnë rritjen e eficiencës në planifikimin strategjik dhe monitorimin e performancës së politikave të zbatuara; ngritjen e sistemeve të informacionit për sistemet e planifikimit të politikave dhe financave publike; ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit horizontal midis ministrive, si edhe brenda ministrive të linjës; si edhe krijimin e mekanizmave të kontrollit të efektshmërisë së legjislacionit.</p> | | | | |
| <p>Objektivi kryesor/ Qëllimi i politikës</p> | <p>Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime më cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive, dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative, dhe përputhet me kërkesat e integrimit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave eficiente. Sistem transparent i hartimit të ligjeve, gjithëpërfshirës, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis</p> | | | | |
| <p>Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi</p> | <p>Përmirësim i shërbimeve publike</p> | <p>Administrimi më efikas i burimeve publike</p> | <p>Rritja e integritetit publik</p> | <p>Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave</p> | <p>Krijimi i një komuniteti më të sigurt</p> |

| | | | | | | |
|---|--|---|-------------------------|---|-----------------|--------------------------|
| | | X | X | X | X | |
| Eshtë e rendësishme për përmirësimin e: | | Transparençës | Përgjegjësisë | Pjesëmarrjes qytetare | | Teknologji dhe inovacion |
| | | X | X | X | | X |
| Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit | Indikatorët e Rezultatit | Indikatorët e Outputit | Institucioni Përgjegjës | Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2016-2018 | Data e fillimit | Data e mbarimit |
| 3.1 Hartimi i metodologjisë për përgatitjen e dokumenteve strategjike (strategji, programe, plane veprimi, dokumente politikash etj). | IPSIS go live në 2019 si sistem funksional | Metodologjia e përgatitur | DZHM/IPSIS | Angazhim i ri | 2018 | 2019 |
| 3.2 Hartimi i paketës ligjore për funksionalitetin e sistemit IPSIS | | Paketa e plotë rregullatore e hartuar dhe miratuar (1 VKM për IPSIS si e-regjister; 1 VKM për funksionalitetin e IPSIS; 2 Urdhra të KM për modulet e IPSIS në lidhje me përgatitjen e strategjive, planeve të veprimit, raportet e monitorimit, programet; IPS kalendar; Ndryshimet | DZHM/IPSIS | Angazhim i ri | 2018 | 2019 |

| | | | | | | |
|---|---|--|------------|---------------|------|------|
| | | në Udhëzimet e përvitshme të PBA) | | | | |
| 3.3 Përmirësimi i kapaciteteve të Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & ministrive të linjës në drejtim të monitorimit të politikave/strategjive/planeve të veprimtaro/programeve zhvillimore, në përputhje me metodologjitë e IPSIS & AFMIS | | Nr. i stafëve për politikën në ministritë e linjës i trajnuar | DZHM/IPSIS | Angazhim i ri | 2018 | 2019 |
| 3.4 Rishikimi i bazës ligjore dhe kuadrit rregullator për funksionimin e IPMG-ve dhe/ose SWG për të adresuar sfidat në strukturat e qeverisë dhe ndryshimin e funksioneve | Nr i takimeve të nivelit të lartë për cdo IPMG në sektorët pilot dhe ngritja e IPMGve të reja | Dokumente të rishikuara | DZHM | Angazhim i ri | 2018 | 2018 |
| 3.5 Përgatitja e formateve standarde (tool kit) për funksionimin e IPMG për Mirëqeverisjen & udhëzime operacionale/Progresi IPMG (rishikimi i kuadrit rregullator për funksionimin e IPMG për Mirëqeverisjen) | | Toolkit i përgatitur | DZHM | Angazhim i ri | 2018 | 2018 |
| 3.6 Funksionimi sistematik i Grupit Tematik për Politikëbërjen, si dhe ngritja e rrjetit për politikëbërjen me njësitë e politikave në ministritë e linjës | | Nr. i mbledhjeve të G.T për Politikëbërjen Nr. i mbledhjeve për rrjetin e | DZHM | Angazhim i ri | 2018 | 2018 |

| | | | | | | |
|---|--|---|-------|-----------|------|------|
| | | politikëbërjes me ML-të | | | | |
| 3.7 Përgatitja e Udhëzimeve Operacionale për ministrinë e linjës për kryerjen e procesit të konsultimit publik dhe funksionimin e e-regjistrimit të konsultimit publik. | | Guida Operacionale e hartuar | DZHM | | 2018 | 2018 |
| 3.8 Trajnim / Ngritje kapacitetesh për stafin përgjegjës në ministrinë e linjës për përdorimin e e-platformës së konsultimit publik | | Nr I stafite trajnuar | AKSHI | | 2018 | 2018 |
| 3.9 Monitorimi i rregullt i realizimit të procesit të konsultimit publik | | Raportet e monitorimit të hartuara (raporti i parë i përgatitur në TM I 2019) | DZHM | Angazhimi | 2018 | 2020 |
| 3.10 Vendosja e rregullave që bëjnë të detyrueshëm zbatimin e procesit të Vlerësimit të Ndikimit | | Per ndryshimin e VKM 584 date 28.08.2003 , miratimi 08.2003 me ndryshime e miratuar | DRRP | Angazhimi | 2018 | 2018 |
| 3.11 Forcimi i kapaciteteve, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të nëpunësve (Rrjeti RIA) në ministrinë e linjës dhe Kryeministri, me qëllim përmirësimit të vlerësimit të ndikimit rregullator | | Numri i nëpunësve të trajnuar | ASPA | Angazhimi | 2018 | 2019 |

| | | | | | | |
|---|---|-------------------------------|------|-----------|---------|---------|
| 3.12 Përmirësimi i procesit të planifikimit të hartimit të akteve ligjore nëpërmjet përcaktimit të afateve dhe rregullave të përgjithshme të procesit të hartimit të PPAP | % e akteve ligjore të hartuara dhe miratuara në përputhje me Programin e Përgjithshëm Analitik Projektakëve | Procedurat e reja të hartuara | DRRP | Angazhimi | Cdo vit | Cdo vit |
|---|---|-------------------------------|------|-----------|---------|---------|

Komponenti IV: Qeverisje e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta

Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është

- *kontrolli dhe denoncimi i praktikave korruptive në institucionet publike nga Task Forca Antikorrupsion*
- *rritja e transparencës të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në monitorimin e zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.*
- *nxitja e qytetarëve për të përdorur mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit*
- *përmirësimi i trajtimit të denoncimeve kundër korrupsionit*
- *është forcimi i mekanizmave parandalues për antikorrupsionin*

| KOMPONENTI IV: QEVERISJE E HAPUR PËR KRIJIMIN E KOMUNITETEVE TË SIGURTA | | |
|--|-----------------------------------|---|
| Institucioni udhëheqës | | Ministria e Drejtësisë |
| Pjesëmarrës të tjerë | Qeveria | KKK/MD ADB DPPSH ILDKPKI |
| | Shoqëria Civile Sektori privat | “Shoqëria e hapur për Shqipërinë” SOROS INFOCIP |
| Status quo ose problemi/çështja që adresohet | | <p>Korrupsioni është pengesa kryesore në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror të shteteve. Në vitin 2013, Shqipëria shënoi sërish për të tretin vit radhazi vendin e fundit, nga vendet e rajonit në renditjen e indeksit global të perceptimit të korrupsionit duke marrë kështu damkën si vendi më i korruptuar në Evropë. Ulje – ngritjet e perceptimit publik në 10 vitet e fundit, objektivisht, përkojnë me reformat e kryera ose të munguara të qeverisjes. Për këtë arsye, qeveria e konsideron perceptimin e publikut mbi korrupsionin jo vetëm si tregues për gjendjen reale të tij (të korrupsionit) por edhe si masë për suksesin apo dështimin e politikave dhe programeve të qeverisë në luftën kundër korrupsionit.</p> <p>Përkundrejt këtij sfondi faktesh dhe kësaj vetëdije politike e shoqërore, me objektivin përfundimtar të modernizimit të qeverisjes në vend, qeveria angazhohet për luftë pa kompromis dhe zero tolerancë kundër korrupsionit duke i dhënë kësaj politike publike përparësinë që meriton. Përparësia e qeverisë në këtë fushë, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t’i ndjekë me përparësi në procesin e integritimit evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i</p> |

| | | | | | | |
|---|--------------------------|--|---|----------------------------------|---|---------------------------------------|
| | | <p>korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.</p> <p>Në përgjigje të nevojave të vendit për zhvillim, dhe pritshmërive të ligjshme të publikut dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, qeveria synon të ndërmarrë një përpjekje në luftën kundër korrupsionit e cila të përfshijë një qasje të trefishtë parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere. Angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e përcaktuara janë në linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe rekomandimet e KE-së për Shqipërinë për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian.</p> <p>Korrupsioni dhe luftimi i tij vijojnë të jenë një nga sfidat kryesore dhe një nga prioritetet madhore ndërsektoriale për Shqipërinë. Gjatë viteve 2007-2010 reformat e ndërmarra nga qeveria kanë synuar modernizimin e administratës shtetërore dhe proceset e saj të punës, duke kontribuar kështu në parandalimin e korrupsionit në fusha ku korrupsioni ishte në nivele tepër të larta dhe ku ndikimi mbi ekonominë e vendit ishte i ndjeshëm.</p> <p>Kështu përmes reformave rregullatore në fushën e auditimit, krijimi i sistemit të prokurimit elektronik me qëllim rritjen e transparencës në fushën e prokurimeve publike, u shënuar rritje e performancës së qeverisë në këto fusha, çka evidentohet edhe nga treguesit e përbërë të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare. Po kështu, krijimi i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve, Qendrës Kombëtare të Licencimit të Bizneseve, si dhe ngritja e sistemeve të E-tatimeve dhe E-doganave, ka lehtësuar ndjeshëm procedurat administrative përkatëse dhe ka reduktuar kontaktet personale të përdoruesve/kërkuesve të shërbimit me administratën, si dhe ka kontribuar në uljen e nivelit të korrupsionit në këta sektorë.</p> | | | | |
| Objektivi kryesor/ Qëllimi i politikës | | Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është Kontrolli dhe denoncimi i praktikave korruptive në institucionet publike nga Task Forca Antikorrupsion | | | | |
| Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi | | Përmirësi mi shërbimeve publike | Administrimi më efikas i burimeve publike | Rritja e integritetit publik | Rritja e përgjegjshërisë së korporatave | Krijimi i një komuniteti më të sigurt |
| | | X | | X | X | X |
| Është e rëndësishme për përmirësimin e: | | Transparencës | Përgjegjësi së | Pjesëmarrjes qytetare | | Teknologji dhe inovacion |
| | | X | X | | | |
| Arritjet e matshme dhe të verifikueshme | Indikatorët e Rezultatit | Indikatorët e Outputit | Institucion i Përgjegjës | Angazhim i ri apo i vazhduar nga | Data e fillimit | Data e mbarimit |

| | | | | | | |
|--|---|--|---|---|---|---------------------------------------|
| për përmbushjen e angazhimit | | | | plan veprimi i 2016-2018 | | |
| 4.1.1 Ngritja e grupeve të kontrollit | Nr. i raporteve të kontrolleve të grupeve të kontrollit; Nr. i masave të marra në përfundim të kontrolleve; Nr. i rasteve të referuara na prokurori | Përmirësi mi i indeksit të perceptimit të korrupsionit | KKK/MD | Angazhim i ri | Prill 2018 | Vazhdon |
| 4.1.2 Hartimi i një kalendarit/plani kontrollit | | | | Angazhim i ri | Prill 2018 | Vazhdon |
| 4.1.3 Kryerja e kontrolleve në institucione publike | | | | Angazhim i ri | Prill 2018 | Vazhdon |
| 4.1.4 Konstatimi/përpilimi i raportit të kontrollit | | | | Angazhim i ri | Prill 2018 | Vazhdon |
| 4.1.5 Masa të propozuara | | | | | | |
| 2 | | | | | | |
| Objektivi kryesor/ Qëllimi i politikës | | Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është rritja e transparencës të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në monitorimin e zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. | | | | |
| Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi | | Përmirësi mi shërbimeve publike | Administrimi më efikas i burimeve publike | Rritja e integritetit publik | Rritja e përgjegjshërisë së korporatave | Krijimi i një komuniteti më të sigurt |
| | | | | X | X | |
| Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e: | | Transparencës | Përgjegjësi së | Pjesëmarrjes qytetare | | Teknologji dhe inovacion |
| | | X | X | X | | X |
| Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit | Indikatorët e Rezultatit | Indikatorët e Outputit | Institucioni Përgjegjës | Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2016-2018 | Data e fillimit | Data e mbarimit |
| 4.2.1 Komunikime online të KKK për rastet e kontrolleve të TF AK | Raportimet e KKK Publikimi i të dhënave të kontrollit | Informimi i publikut për rastet e korrupsionit | KKK/MD | Angazhim i ri | Prill 2018 | Vazhdon |
| 4.2.2 Publikimi dhe aksesueshmëria e publikut dhe grupeve | | | | Angazhim i ri | Prill 2018 | Vazhdon |

| | | | | | | |
|--|---|---|---|---|---|---------------------------------------|
| të interesuara për gjetjet e kontrolleve të kryera | | onit me mjete audio-vizuale, etj | | | | |
| 3 | | | | | | |
| Objektivi kryesor/ Qëllimi i politikës | | Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është nxitja e qytetarëve për të përdorur mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit | | | | |
| Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi | | Përmirësimi i shërbimeve publike | Administrimi më efikas i burimeve publike | Rritja e integritetit publik | Rritja e përgjegjshërisë së korporatave | Krijimi i një komuniteti më të sigurt |
| Është e rëndësishme për përmirësimin e: | | Transparenca | Përgjegjësi | Pjesëmarrja qytetare | | Teknologji dhe inovacion |
| | | X | X | | | |
| Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit | Indikatorët e Rezultatit | Indikatorët e Outputit | Institucioni Përgjegjës | Angazhimi i ri apo i vazhduar nga plani veprimi i 2016-2018 | Data e fillimit | Data e mbarimit |
| 4.3.1 Raportimi periodik i ADB mbi denoncimet në platformë | Raporti periodik i prodhuar dhe i bërë publik | Informimi i publikut për rastet e korrupsionit me mjete audio-vizuale, etj | ADB | Angazhimi i ri | Tetor 2018 | Vazhdon |
| 4 | | | | | | |
| Objektivi kryesor/ Qëllimi i politikës | | Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është përmirësimi i trajtimit të denoncimeve kundër korrupsionit | | | | |
| Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi | | Përmirësimi i shërbimeve publike | Administrimi më efikas i | Rritja e integritetit publik | Rritja e përgjegjshërisë së | Krijimi i një komuniteti më të sigurt |

| | | | | | | |
|--|--|---|-------------------------|--|-----------------------------|-----------------|
| | | | burimeve publike | | korporatave | |
| | | X | | X | X | X |
| Është e rëndësishme për përmirësimin e: | Transparen cës | Përgjegjë sisë | Pjesëmarrjes qytetare | | Teknologji dhe inovacion | |
| | X | X | X | | X | |
| Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit | Indikatorët e Rezultatit | Indikatorët e Outputit | Institucioni Përgjegjës | Angazhimi i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2016-2018 | Data e fillimit | Data e mbarimit |
| 4.4.1 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve kundër korrupsionit | Ndjekja, hetimi dhe trajtimi me përparësi nga struktura të specializuara kundër korrupsionit të denoncimeve të qytetarëve Mbajtja e të dhënave të krahasueshme për veprat penale të korrupsionit në nivele të larta Rakordim ndërinstucional për veprat penale të hetimit të korrupsionit në nivele të larta | Rritja e numrit të denoncimeve kundër korrupsionit në administratë; Rritja e bashkëpunimit ndërinstucional në hetimin e rasteve kundër korrupsionit në nivele të larta | DPPSH | Angazhimi i ri | Tremujori 4, 2018 | 2020 |
| 5 | | | | | | |
| Objektivi kryesor/ Qëllimi i politikës | | Qëllimi i politikës të kësaj veprimtarie është forcimi i mekanizmave parandalues për antikorrupsionin | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|--|---|---------------------------------------|
| Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi | | Përmirësim i shërbimeve publike | Administrimi më efikas i burimeve publike | Rritja e integritetit publik | Rritja e përgjegjsh mërisë së korporatave | Krijimi i një komuniteti më të sigurt |
| | | X | X | X | | X |
| Është e rëndësishme për përmirësimin e: | | Transparenca | Përgjegjësisë | Pjesëmarrjes qytetare | | Teknologji dhe inovacion |
| | | X | X | X | | X |
| Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit | Indikatorët e Rezultatit | Indikatorët e Outputit | Institucioni Përgjegjës | Angazhimi i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2016-2018 | Data e fillimit | Data e mbarimit |
| 4.5.1 Përfundimi i procedurës së prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës për zhvillimin e softëare | Deklarimi i pasurive online nga subjektet deklarues | Deklarimi i pasurive online nga subjektet deklarues | ILDKP KI | Angazhimi i ri | Tremujori I, 2018 | Tremujori I, 2018 |
| 4.5.2 Përfundimi i procedurës së prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës për infrastrukturën e hardëare | | | | | Tremujori 3, 2018 | Tremujori 3, 2018 |
| 4.5.3 Dizanjimi i softëare | | | | | Tremujori 4, 2018 | Tremujori 4, 2018 |
| 4.5.4 Zhvillimi i sistemit dhe ngritja e infrastruktures | | | | | Tremujori 4, 2018 | Tremujori 4, 2018 |
| 4.5.5 Zbatimi, virtualizimi/përfundimi i sistemit operativ, instalimi i | | | | | | |

Shtojca I: Struktura

PLANI I VEPRIMIT 2018 – 2020 PËR PARTNERITET & QEVERISJE TË HAPUR

Pas nisjes zyrtare të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur, Qeveria shqiptare mbështet vlerat e promovuara nga kjo iniciativë shumëpalëshe. **Partneriteti për Qeverisjen e Hapur (PQH, ang. OGP) është një ndër instrumentet më të rëndësishme për të nxitur transparencën qeveritare në nivel global, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike dhe për të përdorur teknologjitë e reja për të përmirësuar efikasitetin administrative dhe luftuar korrupsionin.**

Dokumenti i Planit të Veprimit 2020 do të ketë strukturën e mëposhtme, sipas kapitujve përkatës:

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrje

Pjesa hyrëse shpjegon se çfarë përfaqëson Dokumenti i Planit të Veprimit 2020 në kuadër të planifikimit strategjik për njësitë e qeverisjes qendrore (Sistemit të Planifikimit të Integruar).

Kjo pjesë hartohet nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, Sekretariati Teknik i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur.

2. Konteksti i Iniciativës Globale dhe Plani i Veprimit 2018-2020

Ky kapitull përmban dy pjesë kryesore:

- Pjesa e parë fokusohet në një analizë përmbledhëse për situatën lidhur me zbatueshmërinë e Planit 2016-2018 kundrejt komponentëve kryesore.
 - Kjo pjesë hartohet nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes. Për të hartuar këtë pjesë, do të përdoret Rpaorti i Monitorimit për zbatueshmërinë e viteve 2016-2018.
- Pjesa e dytë do të fokusohet në një paraqitje sintetike të 4 komponentëve kryesorë të Planit të Veprimit 2018-2020, që lidhen si më poshtë vijojnë:
 - Komponenti I: Qeverisje e hapur për të rritur transparencën e raportimit qeveritar dhe përmirësuar aksesueshmërinë në informacion;
 - Komponenti II: Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe Qeverisjen E-Gov;
 - Komponenti III: Qeverisje e hapur për ‘Better Regulation’;
 - Komponenti IV: Qeverisje e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta;

Kjo pjesë hartohet nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, Sekretariati Teknik i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur.

3. Qëllimet Strategjike/komponentët e Planit të Veprimit

3.1 Qëllimet strategjike

- **Qëllimet Strategjike/komponentët kryesore të Planit të Veprimit:** do të paraqiten qëllimet strategjike/komponentët kryesore, ku do të bazohet Plani i Veprimit.
Komponenti I: Qeverisje e hapur për të rritur transparencën e raportimit qeveritar dhe përmirësuar aksesueshmërinë në informacion;
Komponenti II: Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe Qeverisjen E-Gov;
Komponenti III: Qeverisje e hapur për ‘Better Regulation’;
Komponenti IV: Qeverisje e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta;

Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent

Komponenti I: Qeverisje e hapur për të rritur transparencën e raportimit qeveritar dhe përmirësuar aksesueshmërinë në informacion; LFP: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë*
Komponenti II: Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe Qeverisjen E-Gov; LFP: *Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit*
Komponenti III: Qeverisje e hapur për ‘Better Regulation’; LFP: *Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, Sekretariati Teknik i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur*
Komponenti IV: Qeverisje e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta; *Ministria e Drejtësisë*

3.2 Indikatorë

- **Qëllimet përshkruhen në mënyrë konçize për periudhën afatmesme.** Çdo komponent i Planit mund të ketë një ose më shumë qëllime strategjike, të cilat duhet të përmbajnë rezultate specifike, qartësisht të matshëm, të prekshëm dhe të realizueshëm në një kuadër të përcaktuar kohor, dhe që ndikohen plotësisht nga aktivitetet e qeverisë.
- Ekstraktimi i Listës së Indikatorëve (nëse paraqitet rasti). Lista e indikatorëve paraqitet sipas Aneksit 1. *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent.*

PJESA II: QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË KUADRIT STRATEGJIK

4. Qëllimi i Politikës 1 – (Formulimi i Qëllimit të Politikës)

Ky kapitull është pjesë thelbësore e Planit të Veprimit. Ky seksion paraqet politikat përparësore për çdo komponent. Pra, çdo sektori, i nënrenditen politikat dhe objektivat e politikave për arritjen e qëllimeve strategjike të përshkruara në kapitullin pararendës.

Theksi në këtë seksion vihet në paraqitjen e qëllimeve të politikave dhe objektivave specifike, duke siguruar lidhjen logjike midis qëllimeve të politikave për sektorët, si dhe objektivave specifike për komponentët e Planit të Veprimit.

- *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent.*

Matrica e objektivave specifike dhe indikatorëve të rezultatit në përputhje me Aneksin 2.

4.1 Objektivat Specifikë

Analiza e situatës dhe sfidat

- Në dokumentin e Planit të Veprimit paraqiten objektivat specifike për çdo komponent. *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent.*

4.1.1 Indikatorë Rezultati/Key outcome Indicator – formulimi, përshkrimi, vlera e synuar²;

4.1.2 Indikatorë Rezultati/Key outcome Indicator – formulimi, përshkrimi, vlera e synuar;

4.1.3 Indikatorë Rezultati/Key outcome Indicator – formulimi, përshkrimi, vlera e synuar;

4.1.4 Indikatorë Rezultati/Key outcome Indicator – formulimi, përshkrimi, vlera e synuar;

4.1.5 Indikatorë Rezultati/Key outcome Indicator – formulimi, përshkrimi, vlera e synuar;

² Pasaporta e indikatorëve të identifikuar

PJESA III: MASAT PRIORITARE PËR IMPLEMENTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT

Masat prioritare

5.1 Masa prioritare 1

Masa prioritare përfshin masa/projekte investimesh dhe masa mbështetëse/buta (hard& soft measures), të cilat kontribuojnë direkt në arritjen e qëllimit të politikave të identifikuar në seksionin pararendës. *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent.*

5.2 Masa prioritare 2

Masa prioritare përfshin masa/projekte investimesh dhe masa mbështetëse/buta (hard& soft measures), të cilat kontribuojnë direkt në arritjen e qëllimit të politikave të identifikuar në seksionin pararendës. *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent.*

PJESA IV: BUXHETIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Ky kapitull kryen një vlerësim të përgjithshëm të kostove për çdo komponentë në bazë të masave/ produkteve të paraqitura. *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent dhe konsolidohet nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, Sekretariati Teknik i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.*

PJESA V: LLOGARIDHËNIA & MONITORIMI & KOORDINIMI I KUADRIT STRATEGJIK

Në këtë seksion paraqitet sistemi i monitorimit të Planit të Veprimit.

Në këtë seksion përshkruhet mënyra e monitorimit të Planit të Veprimit, duke paraqitur instrumentin që përdoret për monitorim (Raporti i Progresit të kuadrit strategjik), si edhe procesin e hartimit, mënyrë së raportimit, si edhe konsultimit të raportit.

Gjithashtu, pjesë e këtij seksioni është edhe përshkrimi i mekanizmi i monitorimit të performancës.

Shtojca II: Struktura për Lead Focal Point (Ministritë Drejtuese për çdo komponent)

PLANI I VEPRIMIT 2018 – 2020 PËR PARTNERITET & QEVERISJE TË HAPUR

3. Qëllimet Strategjike/komponentët e Planit të Veprimit

3.1 Qëllimet strategjike

- **Qëllimet Strategjike/komponentët kryesore të Planit të Veprimit:** do të paraqiten qëllimet strategjike/komponentët kryesore, ku do të bazohet Plani i Veprimit.

Komponenti I: Qeverisje e hapur për të rritur transparencën e raportimit qeveritar dhe përmirësuar aksesueshmërinë në informacion;

Komponenti II: Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe Qeverisjen E-Gov;

Komponenti III: Qeverisje e hapur për ‘Better Regulation’;

Komponenti IV: Qeverisje e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta;

Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent

Komponenti I: Qeverisje e hapur për të rritur transparencën e raportimit qeveritar dhe përmirësuar aksesueshmërinë në informacion: LFP: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë*

Komponenti II: Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe Qeverisjen E-Gov: LFP: *Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit*

Komponenti III: Qeverisje e hapur për ‘Better Regulation’; LFP: *Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, Sekretariati Teknik i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur*

Komponenti IV: Qeverisje e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta; *Ministria e Drejtësisë*

3.2 Indikatorë

- **Qëllimet përshkruhen në mënyrë koncize për periudhën afatmesme.** Çdo komponent i Planit mund të ketë një ose më shumë qëllime strategjike, të cilat duhet të përmbajnë rezultate specifike, qartësisht të matshëm, të prekshëm dhe të realizueshëm në një kuadër të përcaktuar kohor, dhe që ndikohen plotësisht nga aktivitetet e qeverisë.
- Ekstraktimi i Listës së Indikatorëve (nëse paraqitet rasti). Lista e indikatorëve paraqitet sipas Aneksit 1. *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent.*

PJESA II: QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË KUADRIT STRATEGJIK

4. Qëllimi i Politikës 1 – (Formulimi i Qëllimit të Politikës)

Ky kapitull është pjesë thelbësore e Planit të Veprimit. Ky seksion paraqet politikat përparësore për çdo komponent. Pra, çdo sektori, i nënrenditen politikat dhe objektivat e politikave për arritjen e qëllimeve strategjike të përshkruara në kapitullin pararendës.

Theksi në këtë seksion vihet në paraqitjen e qëllimeve të politikave dhe objektivave specifike, duke siguruar lidhjen logjike midis qëllimeve të politikave për sektorët, si dhe objektivave specifike për komponentët e Planit të Veprimit.

- *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent.*

Matrica e objektivave specifike dhe indikatorëve të rezultatit në përputhje me Aneksin 2.

4.1 Objektivat Specifikë

Analiza e situatës dhe sfidat

- Në dokumentin e Planit të Veprimit paraqiten objektivat specifike për çdo komponent. *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent.*

4.1.1 Indikatorë Rezultati/Key outcome Indicator – formulimi, përshkrimi, vlera e synuar³;

³ Pasaporta e indikatorëve të identifikuar

- 4.1.2 Indikatorë Rezultati/Key outcome Indicator – formulimi, përshkrimi, vlera e synuar;
- 4.1.3 Indikatorë Rezultati/Key outcome Indicator – formulimi, përshkrimi, vlera e synuar;
- 4.1.4 Indikatorë Rezultati/Key outcome Indicator – formulimi, përshkrimi, vlera e synuar;
- 4.1.5 Indikatorë Rezultati/Key outcome Indicator – formulimi, përshkrimi, vlera e synuar;

PJESA III: MASAT PRIORITARE PËR IMPLEMENTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT

Masat prioritare

5.1 Masa prioritare 1

Masa prioritare përfshin masa/projekte investimesh dhe masa mbështetëse/buta (hard& soft measures), të cilat kontribuojnë direkt në arritjen e qëllimit të politikave të identifikuar në seksionin pararendës. *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent.*

5.2 Masa prioritare 2

Masa prioritare përfshin masa/projekte investimesh dhe masa mbështetëse/buta (hard& soft measures), të cilat kontribuojnë direkt në arritjen e qëllimit të politikave të identifikuar në seksionin pararendës. *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent.*

PJESA IV: BUXHETIMI I PLANIT TË VEPRIMIT

Ky kapitull kryen një vlerësim të përgjithshëm të kostove për çdo komponentë në bazë të masave/ produkteve të paraqitura. *Kjo pjesë hartohet 4 Lead Focal Point për çdo komponent dhe konsolidohet nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, Sekretariati Teknik i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.*

**Shtojca III: Lista e Institucioneve të përfshira sipas komponentëve për hartimin e Planit të Veprimit 2018 – 2020 & lidhja me strategjitë sektoriale
PLANI I VEPRIMIT 2018 – 2020
PËR PARTNERITET & QEVERISJE TË HAPUR**

| Nr. | Pjesët e fushave dhe sektorëve për hartimin e Planit të Veprimit & lidhja me strategjitë sektoriale |
|-----------|--|
| I | Komponenti I: Qeverisje e hapur për të rritur transparencën e raportimit qeveritar dhe përmirësuar aksesueshmërinë në informacion – lidhja me Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2020; Drejtohet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, përmes mekanizimit Komitetit të Menaxhimit të Financave Publike |
| 1.1 | Nënkomponent: Accounting (Strategjia e Financave Publike, shtylla 4) |
| 1 | Departamenti i Thesarit |
| 2 | Instat |
| 3 | Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik Drejtoria e Operacioneve të Thesarit |
| 1.2 | Nënkomponent: Monitorimi & Raportimi i performances financiare (Strategjia e Financave Publike, Shtylla 4) |
| 1 | Drejtoria për Monitorimin dhe Zbatimin e Buxhetit të Financave Lokale |
| 1.3 | Nënkomponent: Aksesueshmëria e informacionit (Strategjia e Antikorrupsioni: A1 & A2) |
| 1 | Ministria e Drejtësisë |
| 2 | Komisioneri për të drejtën e informimit |
| | |
| II | Komponenti II: Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe Qeverisjen E-Gov – lidhja me Strategjinë e Reformës së Administratës Publike, Dokumentin e Politikave për Shërbimet dhe Strategjinë Agjenda Digjitale Drejtohet nga Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit përmes mekanizimit të Grupit Tematik E-Gov, GMIP për Mirëqeverisje |

| | |
|------------|--|
| 1 | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit |
| 2 | Ministria e Mbrojtjes |
| 3 | Ministria e Brendshme |
| 4 | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| 5 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| 6 | Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë |
| 7 | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë |
| 8 | Ministria e Drejtësisë |
| 9 | Ministria e Kulturës |
| 10 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| 11 | Ministria e Mjedisit dhe Turizmit |
| 12 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| 13 | Ministri i Shtetit për Diasporën |
| 14 | Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes |
| 15 | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Kryeministria |
| 16 | ISDA/ ADISA |
| 17 | ASIG |
| 18 | DAP |
| 19 | AKCESK |
| 20 | Perfaqesues të Autoriteve lokale |
| 21 | Perfaqesues organizmave të huaja dhe vendase |
| 22 | Perfaqesues të rrethëve akademike |
| 23 | Perfaqesues të grupeve të interesit |
| | |
| III | Komponenti III: Qeverisje e hapur për ‘Better Regulation’, lidhja me Strategjinë e Reformës së Administratës Publike dhe Strategjinë e Drejtësisë Drejtohet nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, përmes mekanizimit të Grupit Tematik të Politikbërjes, GMIP të Mirëqeverisjes |
| 1 | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri |

| | |
|-----------|---|
| 2 | Departamenti Rregullator dhe Përputhshmërisë, në Kryeministri; |
| 3 | Departamenti i Burimeve, Transparencës dhe Administrimit |
| 4 | Ministria e Drejtësisë |
| 5 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| 6 | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| 7 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| 8 | INSTAT |
| 9 | BE |
| 10 | Shoqëria Civile |
| | |
| IV | Komponenti IV: Qeverisje e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta, lidhja me Strategjinë e Antikorrupsionit & Reformës së Administratës Publike Drejtohet nga Ministria e Drejtësisë, përmes mekanizimit të Grupit Tematik të Antikorrupsionit, GMIP Mirëqeverisja |
| 1 | Ministria e Drejtësisë |
| 2 | Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë |
| 3 | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë |
| 4 | Ministria e Kulturës |
| 5 | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| 6 | Ministria e Brendshme |
| 7 | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| 8 | Ministria e Mjedisit dhe Turizmit |
| 9 | Ministria e Mbrojtjes |
| 10 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| 11 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| 12 | Ministri i Shtetit për Diasporën |
| 13 | Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes |
| 14 | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri; |
| 15 | Departamenti Rregullator dhe Përputhshmërisë, në Kryeministri; |

| | |
|----|---|
| 16 | Departamenti i Burimeve, Transparencës dhe Mirëadministrimit, në Kryeministri |
| 17 | Prokuroria e Përgjithshme |
| 18 | KLD (Deri sa te krijohen KLGJ dhe KLP) |
| 19 | BE |
| 20 | Shoqeria Civile |
| | |

Shtojca IV: Metodologjia për procesin e hartimit PLANI I VEPRIMIT 2018 – 2020 PËR PARTNERITET & QEVERISJE TË HAPUR

I. Hyrje: Sistemi i Planifikimit të Integruar

Planifikimi strategjik në Shqipëri bazohet mbi Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI), i cili është miratuar me fillimisht me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr.244, datë 21.4.2005 dhe më pas me VKM, Nr.692, datë 10.11.2005⁴. SPI-ja ka si synim të sigurojë një kuadër të gjerë planifikimi brenda të cilit të gjitha politikat dhe planifikimi financiar i qeverisë të funksionojnë në mënyrë koherente, efçente dhe të integruar. SPI konsiston në një kuadër parimesh dhe strukturash operuese që mundësojnë lidhjen më të harmonizuar të mundshme të gjithë proceseve planifikuese mes tyre.

Dy janë proceset themelore ku mbështetet SPI-ja:

- Një proces afatmesëm deri në afatgjatë të planifikimit strategjik, **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)**, e cila vendos prioritetet dhe qëllimet strategjike;
- Një proces i buxhetimit afatmesëm, **Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA)**, i cili kërkon që çdo ministri të hartojë një plan trevjeçar brenda tavaneve të shpenzimeve buxhetore për të arritur objektivat e politikave, në përputhje me SKZHI;

II. Lidhja e proceseve dhe hartimi i Planit të Veprimit 2018-2020

Metodologjia për procesin e hartimit të Planit të Veprimit 2018-2020 (Për Partneritet & Qeverisje të Hapur) bazohet në parimin e funksionimit të plotë të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale të lidhura me Sistemin e Planifikimit të Integruar.

Hartimi i Planit të Veprimit 2018-2020 (PQH) mbështetet vecanërisht në harmonizimin sa më të mirë me ciklin e Programimit Buxhetor Afatmesëm dhe me Planin Kombëtar për

⁴ Miratuar fillimisht me VKM nr.244, datë 21.4.2005, “Për miratimin e strategjisë “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar”, i cili u shfuqizua me VKM nr. 692, datë 10.11.2005, “Për miratimin e strategjisë së ripunuar “Konsolidimi i një sistemi planifikimit të integruar në Shqipëri”

Integrimin Evropian (PKIE) si dhe me programimin strategjik të vendit (strategjitë sektoriale & ndërsektoriale).

Në vecanti, **Planit të Veprimit 2018-2020 (PQH)** do të harmonizojë:

- **Lidhjen me prioritetet e Qeverisë Shqiptare dhe SKZHI II**, ku prioritetet e parashikuara në programin e Qeverisë, si edhe sektorët prioritarë të Qeverisë, janë pjesë integrale e vizionit dhe politikave që përcakton SKZHI.
- **Lidhjen e plotë midis PBA me PKIE**, ku aktivitetet, masat dhe angazhimet në kuadër të MSA janë pjesë integrale e PBA-së dhe e SKZHI.
- **Lidhjen me politikat e përfshira në strategjitë kombëtare sektoriale dhe ndërsektoriale të vendit.**

2.1 Kuadri institucional për hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020

Niveli vendimmarrës

Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administrimit Publik: miraton Planin e Veprimit 2018-2020 për PQH-në.

Zëvendëskryeministri është Koordinatori Kombëtar në nivel politik për PQH-në dhe udhëheq GMIP-në për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik.

GMIP e MQ&AP përqëndrohet në prioritetin e Qeverisë Shqiptare për 'Mirëqeverisjen' në nivel qendror dhe lokal, e cila përbën themelin e SKZHI-së, duke synuar përmirësimin ofrimit të Shërbimeve Publike, përmirësimin e qeverisjes së hapur, përmirësimin e qeverisjes së sektorit publik dhe atij privat, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Qeverisja e fortë dhe efektive mbështet konkurrencën dhe rritjen, sepse ajo siguron një kornizë rregulluese të mirëfilltë për biznesin, grupet shoqërore dhe qytetarët dhe është thelbësore për anëtarësimin në BE. Qeverisja e mirë nxit llogaridhënien dhe transparencën e sektorit publik, si dhe decentralizimin efektiv dhe demokracinë në nivel lokal.

GMIP e MQ&AP kordinon politikat dhe monitorimin e zbatimit në këtë sektor më të gjerë përmes hartimit dhe zbatimit të një Kalendarit Pune që mbulon masat në lidhje me avancimin e shoqërisë civile, decentralizimin dhe qeverisjen lokale, reformën e administratës publike, ofrimin e shërbimeve publike, transparencën & anti-korrupsion, statistika, e-qeverisje dhe dixhitalizim dhe masa mbështetëse për Parlamentin.

Sekretariati Teknik për GMIP & OGP

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes është sekretariati teknik i GMIP-së si dhe koordinon procesin e hartimit dhe mbarëvajtjes së Planit të Veprimit 2018-2020 të PQH-së. **Njësia e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes/ Drejtoria e Mirëqeverisjes dhe Sistemeve, pjesë e**

Departamenti, në rolin e Sekretariatit Teknik është përgjegjëse për koordinimin e të gjithë proceseve dhe punës së institucioneve për hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020. Sekretariati ndjek ecurinë e procesit në ministrinë e linjës dhe raporton pranë Zëvendëskryeministrit për çështje të ndryshme të lidhura me PQH-në

Grupet tematike koordinuese

Grupi i Punës në nivelin teknik: Për bashkërendimin në nivel qëndror të institucioneve kyçe dhe menaxhim të të gjithë procesit, funksionojnë në kuadër të GMIP-së për Mirëqeverisje Grupet Tematike.

Grupet Tematike (GT) janë grupe pune ndërministrorë të themeluara nën një GMIP për të koordinuar dhe monitoruar reformat dhe veprimet e ndërlydhura në një nënsektor të veçantë brenda sektorit “me shtrirje të gjerë” të mbuluar nga GMIP.

Grupi për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik mbulon GT me aktivitetin e fushave të mëposhtme

- **Sekretariati në nivelin teknik** GMIP & OGP kryesohet nga drejtori i Njesisë së Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në rolin e Sekretariatit Teknik dhe koordinon punën për:
 - përgatitjen e kapitullit të Kontekstit Strategjik
 - përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve Strategjike/komponentët e Planit të Veprimit
 - përgatitjen e kapitullit të Kuadrit të procesit të monitorimit
- **Grupet Tematike në nivelin teknik** udhëhiqen nga Lead Focal Point për çdo komponent dhe koordinojnë punën për:
 - përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
 - përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
 - përgatitjen e kapitullit të buxhetimit
 -

Ministria e Financave dhe Ekonomisë garanton konsolidimin e kapitullit të buxhetimit. Në proces përfshihen ngushtësisht, si pjesë e grupit teknik të punës, drejtoria e përgjithshme e buxhetit, drejtoria e politikave makroekonomike e fiskale, etj.

Ministria e Drejtësisë garanton analizën e implikimeve legislative të Reformës si dhe propozimet e nevojshme në kuadrin rregullator në mbështetje të Planit të Veprimit.

Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme garanton lidhjen e Planit Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE). Në proces përfshihen ngushtësisht, si pjesë e grupit teknik të punës, drejtoritë që kanë në funksionin e tyre: çështje të programimit IPA, si edhe drejtoritë për çështjet sektoriale dhe integrimin në BE.

Strukturat koordinuese në ministrinë e linjës:

- **Koordinatori për Planin e Veprimit;** përbëhet nga një person kontakti për çdo ministri linje, që koordinon metodologjinë, kalendarin, proceset, raportimet dhe çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Sekretarati Teknik.
- **Koordinatori koordinon punën me Sekretariatit GMIP dhe sekretariatet e Grupeve Tematike pr finalizimin e Planit të Veprimit.**
- Kjo strukturë e posaçme garanton kontrollin e cilësisë për çdo dokument të draftuar dhe diskutuar nga drejtoritë e politikave, programeve, projekteve si edhe eficiencën dhe efektivitetin për procesin e hartimit të Planit të Veprimit, dhe është përgjegjëse për:
 - Ndjekjen dhe zbatimin e planit të punës për draftimin e Kuadrit Strategjik për Sistemin,
 - Raportimin pranë Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, në lidhje me ecurinë e procesit, si dhe relatojnë në grupet respektive për problematikat për zgjidhje,
 - Garanton koordinimin brenda ministrisë për të zbatuar Planin e Punës, në përputhje me kalendarin për hartimin e Kuadrit Strategjik,
 - Garanton cilësinë dhe dërgimin në kohë të drafteve,
 - Siguron mbështetje teknike Sekretarit të Përgjithshëm për kryerjen e aktiviteteve koordinuese në funksion të draftimit të kapitujve respektivë.

2.1.1 Fazat e procesit të hartimit të Planit të Veprimit 2018-2020.

Mobilizimi i procesit me Ministrinë e Linjës (Qershor – Korrik 2018)

Fillimisht, fokusi u vendos në lançimin e procesit të hartimit të PVQH 2018-20 me ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore, si dhe përgatitjen e strukturave përkatëse që u angazhuan në proces. Aktivitete kryesore që u zhvilluan gjatë kësaj faze, nga Sekretariati Teknik, përfshinë:

- Lançimi i procesit në workshop të dedikuar (qershor 2018)
- Zhvillimin e takimeve të veçanta me çdo ministri linje.
- Organizimin e takimeve të Grupeve Tematike:
 - Grupi Tematik i Politikbërjes (qershor - shtator 2018)
 - Grupi Tematik i E-Gov (qershor - shtator 2018)
 - Grupi Tematik i Antikorrupsionit (qershor - shtator 2018)
 - Komiteti i Menaxhimit të Financave Publike (qershor - shtator 2018)

Finalizimi i konsultimit dhe miratimi në Grupet Tematike për komponentët respektive.

Përgjegjësitë kryesore institucionale në këtë fazë ishin:

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri

- Përgatitja e komenteve për draftet e para për politikat dhe masat prioritare nga ministritë e linjës (shtator - tetor 2018)
- Rishikimi dhe përgatitja e draftit për konsultim të Planit të Veprimit (tetor 2018)
- Konsultimi me: grupet e interesit dhe partnerët socialë, donatorët dhe Shoqërinë Civile (tetor 2018)
- Hartimi i treguesve (qershor – shtator 2018)
- Finalizimi i draftit dhe paraqitja për diskutim/aprovim në GMIP (tetor - nëntor 2018)

Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Kryerja e analizave të kërkesave buxhetore dhe organizimi i seancave dëgjimore me ML, në bashkëpunim me Departamentin dhe MEPJ (shtator – tetor 2018)
- Konsolidimi i kapitullit të buxhetit (shtator 2018)
- Përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
- Përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)

Ministria e Drejtësisë/ Grupi Tematik për Antikorrupsionin:

- Përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
- Përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
- Përgatitjen e kapitullit të buxhetimit

Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit/ Grupi Tematik për E-Gov:

- Përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
- Përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 (sipas komponentit respektiv)
- Përgatitjen e kapitullit të buxhetimit

Ministria e Integritit European:

- Paraqitja e komenteve për politikat dhe masat prioritare (qershor - shtator 2018).
- Dhënia e komenteve përfundimtare mbi draftin (shtator - tetor 2018)

Ministritë e linjës :

- Rishikimi i politikave, objektivave dhe masave prioritare (maj - shtator 2018), të cilat duhet të përfshijnë të gjitha angazhimet e politikave të ministrive të linjës lidhur me:
 - Programin e Qeverisë,
 - Prioritetet e ML-ve në kuadër të Prioriteteve,
 - Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit,
 - Marrëveshje dhe angazhime të tjera të Qeverisë,
 - Raportet e Komisionit Evropian
 - çdo dokument tjetër strategjik sektorial dhe ndërsektorial ekzistues,
- Hartimi i treguesve (qershor – shtator 2018)

**Shtojca V: Kalendari i procesit të finalizimit të Planit të Veprimit
2018 – 2020
PËR PARTNERITET & QEVERISJE TË HAPUR**

| Aktivitetet | Afatet kohore | Institucioni Përgjegjës |
|---|-------------------------|--|
| Procesi për finalizimin e Planit të Veprimit PQH 2018-2020 | | |
| Dërgimi me shkresë zyrtare i Koordinatorëve OGP ne cdo institucion/ML | Maj – Qershor | Sekretariati Teknik |
| Formalizimi i Rrjetit Ndërmintor OGP (Partneritet & Qeverisje të Hapur) | Maj – Qershor | Sekretariati Teknik/ Ministrinë e Linjës |
| Krijimi i databazës së të dhënave të Rrjetit Ndërmintor OGP (Partneritet & Qeverisje të Hapur) | Qershor | Sekretariati Teknik |
| Hartimi i paketës/guidave për ministrinë e linjës për hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020 PQH, me dokumentacionet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> - Shtojca I: Struktura metodologjike dhe shpjegime për hartimin e Planit të Veprimit 2018-2020 ‘Për Partneritet & Qeverisje të Hapur’ - Shtojca II: Struktura për Lead Focal Point (Ministrinë Drejtuese për çdo komponent) - Shtojca III: Lista e Institucioneve të përfshira sipas komponentëve për hartimin e Planit të Veprimit 2018 – 2020 & lidhja me strategjitë sektoriale - Shtojca IV: Metodologjia për procesin e hartimit të Planit të Veprimit 2018-2020 ‘Për Partneritet & Qeverisje të Hapur’ - Shtojca V: Kalendari i procesit të finalizimit të Planit të Veprimit 2018-2020 ‘Për Partneritet & Qeverisje të Hapur’ | Qershor | Sekretariati Teknik |
| Dërgimi i Paketës me shkresë zyrtare Koordinatorëve OGP ne cdo institucion/ML | Qershor | Sekretariati Teknik/ Ministrinë e Linjës |
| Workshop lançues me Koordinatorët OGP dhe 4 Lead Component Leader’s <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i procesit, ndarja e detyrave | Qershor - Korrik | Sekretariati Teknik/ Ministrinë e Linjës (tbc) |

| | | |
|--|--------------------------------|---|
| <p>Workshop/mbledhje: Komponenti I: Qeverisje e hapur për të rritur transparencën e raportimit qeveritar dhe përmirësuar aksesueshmërinë në informacion</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 per komponentin respektiv - Përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 per komponentin respektiv - Përgatitja e kostimit dhe buxhetimit te komponentit respektiv | <p>Qershor - Korrik</p> | <p>LFP: Ministria e Financave dhe Ekonomisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Komiteti për Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike</p> |
| <p>Workshop/mbledhje: Komponenti II: Qeverisje e hapur për të modernizuar shërbimet publike dhe Qeverisjen E-Gov</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 per komponentin respektiv - Përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 per komponentin respektiv - Përgatitja e kostimit dhe buxhetimit te komponentit respektiv | <p>Qershor - Korrik</p> | <p>LFP: Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit/ Grupi Tematik për E-Gov</p> |
| <p>Workshop/mbledhje: Komponenti III: Qeverisje e hapur për ‘Better Regulation’; LFP: Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, Sekretariati Teknik i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 per komponentin respektiv - Përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 per komponentin respektiv - Përgatitja e kostimit dhe buxhetimit te komponentit respektiv | <p>Qershor - Korrik</p> | <p>Sekretariati Teknik i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur/ Grupi Tematik për Politikbërjen</p> |
| <p>Workshop/mbledhje: Komponenti IV: Qeverisje e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitjen e kapitullit të Qëllimeve të Politikës dhe Objektivave specifike të Planit të Veprimit 2020 per komponentin respektiv - Përgatitjen e kapitullit të Masave Prioritare për implementimin e Planit të Veprimit 2020 per komponentin respektiv - Përgatitja e kostimit dhe buxhetimit te komponentit respektiv | <p>Qershor - Korrik</p> | <p>LFP: Ministria e Drejtësisë/ Grupi Tematik i Antikorrupsioni/ Komiteti Strategjinë Antikorrupsion</p> |
| <p>Draftimi i pjesës së dytë & pjesës së tretë që lidhen me qëllimet e politikës & objektivat specifike dha masat prioritare e konsoliduar</p> | <p>Korrik – Shtator</p> | <p>ST, LFP, ML</p> |

| | | |
|---|-------------------------|--|
| Draftimi i pjesës së katërt që lidhet me buxhetimin e planit të veprimit | Korrik – Shtator | ST, LFP, ML |
| Draftimi i seksionit të monitorimit | Korrik – Shtator | ST, LFP, ML |
| Diskutimi dhe konsolidimi i draftit të Planit të Veprimit për konsultim publik | Shtator - Tetor | ST, LFP, ML |
| Përgatitja e draftit final të Planit të Veprimit, me pasqyrimin e komenteve publike | Tetor – Nëntor | ST, LFP, ML |
| Diskutimi dhe miratimi i Planit të Veprimit në GMIP Mirëqeverisje | Nëntor- Dhjetor | Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave të Mirëqeverisjes dhe Administrimit Publik |